



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave

DOKUMENT PËR DISKUTIM

Si mund të ndikojë anëtarësimi në BE në barazinë gjinore në Kosovë?

Prishtinë, Kosovë
Dhjetor, 2016

Mbështetur nga:

FEMDEFENDERS
KVINNA TILL KVINNA



Përmbajtja

Përmbajtja.....	2
Mirënjohje.....	3
Shkurtesat.....	3
Përmbledhje ekzekutive.....	4
Hyrje.....	5
Rreth këtij dokumenti.....	8
Një histori e shkurtër e Bashkimit Evropian.....	8
Anëtarësimi në BE në Rajonin e Ballkanit Perëndimor.....	9
<i>Acquis</i> i BE-së për Barazi Gjinore.....	9
Kosova dhe anëtarësimi në BE.....	11
Ndikimi i Anëtarësimin në BE në Barazi Gjinore.....	12
Pjesëmarrja politike.....	12
Arsimimi.....	14
Punësimi.....	16
Hendeku gjinor i pagave.....	18
Varfëria.....	19
Shëndetësia.....	20
Kujdesi ndaj fëmijëve.....	22
Vlerësime tjera të proceseve të anëtarësimin në BE dhe ndikimi i tyre në Barazinë Gjinore.....	23
Përfundim.....	25
Bibliografia.....	27

Mirënjohje

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) falenderon hulumtuesit që kanë kontribuar në këtë PUNIM, duke përfshirë Gresa Rrahmani, Donikë Kastrati dhe Jennifer Davidson e cila ka qenë praktikante në RrGGK mbështetur nga Kolegji Dartmouth. RrGGK gjithashtu falenderon Erica Browne për analizat statistikore dhe Ariana Qosaj-Mustafa për sugjerimet e vlefshme si bashkë-recensuese, ndër të tjera. Drejtoresha Ekzekutive e RrGGK-së Igballe Rogova, Lobi për Barazi Gjinore në Kosovë dhe anëtarët e Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës kanë dhënë komente të vlefshme në gjetjet fillestare të këtij dokumenti. Ky hulumtim u mundësua me mbështetjen financiare të Fondacionit *Kvinna till Kvinna*.

Shkurtesat

KE	Komisioni Evropian
GJED	Gjykata Evropiane e Drejtësisë
EEC	Komuniteti Ekonomik Evropian
IEBGJ	Instituti Evropian për Barazinë Gjinore
ECSC	Traktati Evropian i Qymyrit dhe Çelikut
BE	Bashkimi Evropian
KAS	Agjencia e Statistikave e Kosovës
RRGGK	Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
LBGJ	Ligji për Barazi Gjinore
MIE	Ministria e Integritimit Evropian
OJQ	Organizatë Jo-qeveritare
PKZMSA	Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit
OBEZH	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
MSA	Marrëveshja e Stablizim Asociimit
UK	Mbretëria e Bashkuar
UN	Kombet e Bashkuara
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara

Përmbledhje ekzekutive

Ky punim synon të shqyrtojë ndikimin e mundshëm që mund të ketë anëtarësimi në Bashkimin Evropian (BE) në barazinë gjinore në Kosovë. Punimi nisët nga përvojat e vendeve të tjera të BE-së, duke shqyrtuar shkallën në të cilën anëtarësimi në BE ka pasur efekt pozitiv, negativ ose asnjë efekt në barazinë gjinore. Ndonëse duhet të merren parasysh kontekstet potencialisht të ndryshme politike, ekonomike dhe sociale të këtyre vendeve, mësimet e nxjerra nga vendet e tjera mund të jenë të dobishme për Kosovën.

Në këtë punim janë përdorur metoda të përziera të hulumtimit, duke përfshirë: rishikim të shpejtë të kuadrit ligjor përkatës ekzistues; hulumtim sekondar në lidhje me ndikimin që anëtarësimi në BE ka pasur për barazinë gjinore në vendet e tjera; dhe analizat statistikore të treguesve kyç që kanë të bëjnë me barazinë gjinore. Punimi përqendrohet në atë se si anëtarësimi në BE ka ndikuar në barazi gjinore në lidhje me: pjesëmarrjen politike, arsimin, trajnimin profesional, shëndetin, varfërinë, punësimin, papunësinë, hendekun gjinor të pagave dhe kujdesin ndaj fëmijëve. Në mënyrë të veçantë, metodologjia e përdorur në këtë punim mund të ketë anashkaluar tregues të tjerë të rëndësishëm se si anëtarësimi në BE, mund të ndikojë në barazinë gjinore. Për shkak të problemeve me disponueshmërinë e të dhënave, analiza fokusohet kryesisht në periudhën menjëherë përpara anëtarësimit në BE deri tani. Kufizimet në dimensionet e barazisë gjinore të shqyrtuara dhe disponueshmëria e të dhënave statistikore bëjnë thirrje për kujdes në interpretimin e rezultateve. Në veçanti, mungesa e të dhënave të krahasueshme në të gjitha vendet dhe me kalimin e kohës për vitet e para anëtarësimit në BE mund të nënkuptojnë se disa ndryshime që kishin ndodhur nuk mund të vërehen me të dhënat e analizuar këtu.

Duke pasur parasysh të dhënat e pamjaftueshme në dispozicion, është e vështirë të parashikohet duke përdorur analizat statistikore se si anëtarësimi në BE mund të ndikojë në barazinë gjinore në Kosovë. Në shumicën e dimensioneve të shqyrtuara këtu, Kosova i ndjekë prapa vendet e tjera evropiane si në përgjithësi po ashtu edhe sa i përket barazisë gjinore. Gjetjet sugjerojnë se procesi i negociatave të para-anëtarësimit dhe anëtarësimi zyrtar në BE nuk do t'i adresojë automatikisht pabarazitë gjinore të Kosovës, pavarësisht se si përcaktohet barazia. Kjo duket veçanërisht e mundshme në zonat ku BE-ja mban disa kompetenca, siç janë arsimit dhe politika. Përderisa anëtarësimi në BE mund të ketë një ndikim modest pozitiv në *disa* vende në lidhje me uljen e pabarazive gjinore në papunësi, ngushtimin e hendekut gjinor të pagave dhe përmirësimin e qasjes në arsimin e lartë dhe kujdesin shëndetësor, është vështirë të vlerësohet me një siguri duke pasur parasysh mungesën e të dhënave statistikore të krahasueshme në intervale kohore. Në veçanti, ndryshimi social gjithashtu merr kohë. Përderisa ndryshimet e politikave që ndodhin gjatë procesit të anëtarësimit në BE mund të ndikojnë pozitivisht në barazinë gjinore në afat të gjatë, efektet e tyre mund të mos jenë të dukshme në rrethanat e hershme.

Në këtë mënyrë, procesi i anëtarësimit në BE mund të jetë i rëndësishëm vetvetiu për avancimin e barazisë gjinore, siç është harmonizimi i legjislacionit të Kosovës me *acquis* të BE-së për barazi gjinore dhe parimet kundër diskriminimit. Në të vërtetë, aktivistët për të drejta të grave në vendet e tjera kanë vërejtur dhe theksuar rëndësinë e shfrytëzimit të momentit të procesit të anëtarësimit në BE për të krijuar politikat që do ta mbrojnë dhe ndihmojnë barazinë gjinore në të ardhmen. Në përputhje me Planin e ri të Veprimit Gjinor në BE (GAP),¹ BE-ja mund ta nxitë Qeverinë e Kosovës që të aprovojë politika në përputhje me *acquis* të barazisë gjinore, si dhe të sigurojë zbatimin e tyre. Pëcjellja me kujdes e shkallës në të cilën procesi i anëtarësimit të Kosovës në BE kontribuon në barazinë gjinore me kalimin e kohës mund të sigurojë informata të vlefshme për hulumtuesit dhe politikë-bërësit në të ardhmen.

¹ Këshilli i Bashkimit Evropian, Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit, 'Përfundimet e Këshillit për Planin e Veprimit Gjinor 2016-2020', Bruksel: Këshilli i Bashkimit Evropian, 2015.

Hyrje

Anëtarësimi në BE është prioritet politik për Qeverinë e Kosovës. Kosova ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) në vitin 2015 dhe miratoi Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) në mars të vitit 2016.² Për më tepër, zyrtarët qeveritarë vazhdimisht deklamojnë publikisht angazhimin e tyre për 'integrimin euro-atlantik'.³ Megjithatë, ka pasur pak diskutime publike lidhur me atë se *çfarë domethënie ka më saktë* anëtarësimi në BE në jetën e përditshme të kosovarëve. E akoma më pak informata ekzistojnë në lidhje me dimensionet potencialisht gjinore të anëtarësimit në BE. Nuk ka analiza të njohura që janë shqyrtuar për ndikimin e mundshëm që anëtarësimi në BE mund të ketë mbi gratë dhe vajzat në Kosovë. Në përputhje me Ligjin e Kosovës për Barazi Gjinore (LBGJ), analizat e ndikimit gjinor janë të rëndësishme për informimin e politikave dhe ligjeve të reja,⁴ duke përfshirë edhe ato lidhur me anëtarësimin në BE, duke u siguruar që këto nuk kanë ndikim të dëmshëm në gratë apo burrat.

Në këtë kontekst, ky punim shqyrtton se si anëtarësimi në BE mund të ndikojë në barazinë gjinore, duke nxjerrë mësim nga përvojat e vendeve të tjera. Nëse pabarazitë gjinore janë gjetur të kenë rezultuar nga procesi i anëtarësimit në BE, ky dokument përpiqet të identifikojë se cilat politika do të mund të aplikoheshin në mënyrë që të parandalohej ndonjë efekt i mundshëm negativ ndaj grave dhe burrave në Kosovë. Fillimisht, ky punim synon në këtë mënyrë të informojë procesin e politikë-bërjes në lidhje me anëtarësimin e Kosovës në BE duke mësuar nga përvojat e vendeve të tjera të cilat kanë kaluar këtë proces. Më tej, të kuptuarit e ndikimit që anëtarësimi në BE ka pasur (ose jo) në barazinë gjinore ndoshta është një kontribut për njohuri në vetvete dhe mund të jetë po ashtu interesante për një audiencë më të gjerë.

Metodologjia

Ky hulumtim përpiqet të përgjigjet në pyetjen: si mundet anëtarësimi në BE të ndikojë në barazinë gjinore. Fillimisht, analiza kërkoi që të shqyrtojë ndryshimet që kanë ndodhur gjatë dy afateve të ndryshme: së pari, para dhe pas anëtarësimit në BE, në përgjithësi; dhe së dyti para fillimit të procesit të anëtarësimit në BE dhe pas anëtarësimit në BE. Për të parin, ishte hipoteza se barazia gjinore në një vend do të përmirësohet kur krahasohet periudha para anëtarësimit të një vendi deri në periudhën pas anëtarësimit të vendit, me anëtarësimin aktual që është moment i rëndësishëm për vendin për të treguar përmirësime të rëndësishme në barazinë gjinore. Për të dytin, është hipoteza se procesi i anëtarësimit në BE në *vetvete*, para anëtarësimit në BE, do të mund të kontribuojë në barazinë gjinore, sepse shtetet do të fillonin harmonizimin e ligjeve dhe politikave të tyre me ato të BE-së para anëtarësimit faktik në BE; kjo mund të lejojë që përmirësimet të *shihen gjatë* procesit të anëtarësimit dhe jo domosdoshmërisht vetëm para dhe pas datës në të cilën një vend u bë një Shtet Anëtar i BE-së.

Duke gërmuar më thellë në mbledhjen e të dhënave për të testuar këto dy hipoteza u zbulua, se megjithatë, në dispozicion ishin të dhëna të pamjaftueshme për të vlerësuar ndryshimet që kanë ndodhur gjatë procesit të anëtarësimit në BE. Për këtë arsye, hipoteza e dytë nuk është hetuar në këtë punim. Gjetjet fokusohen në hipotezën e parë: para dhe pas anëtarësimit në BE. Në analizë kryesisht janë përfshirë vendet që u anëtarësuan në BE pas vitit 2000, pasi që ishin në dispozicion më shumë të dhëna për këto vende, duke bërë të mundur krahasimin, para dhe pas anëtarësimit. Të dhënat e pamjaftueshme gjithashtu nënkuptonin se vendet individuale ndonjëherë duhej të hiqeshin nga analiza. Prandaj, për secilin tregues, vendet e analizuar janë përcaktuar me fusnotë. Mungesa e të dhënave të krahasueshme është një kufizim i rëndësishëm për këtë punim, sepse siç sugjeronte hipoteza e dytë e

² Qeveria e Kosovës, "Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit", Prishtinë: Qeveria e Kosovës, 2016.

³ Për shembull, shih: "Intervista e presidentit, Hashim Thaçi për Zërin e Amerikës", Zëri i Amerikës, në: <http://www.president-ksgov.net/?page=1,10,4372#.WE186YWChIU>; Republika e Kosovës, Zyra e Kryeministrit, "Kryeministri Mustafa: Integrimi në BE, vlera drejtuese për shoqërinë e Kosovës"; Republika e Kosovës, Presidenca, "Fjala e Presidentes Jahjaga në takimin e tretë të Këshillit Kombëtar për Integrim Evropian".

⁴ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr 05 / L-020 për Barazi Gjinore, 28 maj 2015.

lartpërmendur, ekziston mundësia që procesi i anëtarësimit në BE, ndonjëherë duke filluar një dekadë para anëtarësimit në BE, mund të ketë kontribuar në barazinë gjinore në disa vende, por nuk kishte të dhëna për të matur këtë. Për shembull, për 13 vendet që u anëtarësuan pas vitit 2000, koha mesatare që nga fillimi i procesit të anëtarësimit në BE deri sa ata u anëtarësuan ishte gjashtë vjet. Koha mesatare prej kur ato kanë aplikuar deri në kohën kur ato u anëtarësuan ishte 10 vite. Shpesh, të dhënat për treguesit ishin në dispozicion vetëm për disa vjet para vitit kur vendi u anëtarësua në BE. Kështu, ajo që më së shumti ky punim mund të masë dhe të arrin në përfundim është nëse procesi i menjëhershëm i anëtarësimit në BE dhe anëtarësimi fillestar në BE kanë ndikuar në barazinë gjinore në afat të shkurtër.

Në matjen e ndryshimeve në barazinë gjinore, në analizë diskutohen ndryshimet për gratë dhe burrat, por më e rëndësishmja hendeku që ekziston *midis* grave dhe burrave. Barazia gjinore e përmirësuar ishte përcaktuar si një zvogëlim i hendekut midis grave dhe burrave, dhe jo vetëm një përmirësim për gratë dhe/ose burrat.

Ekzistojnë disa dimensione potenciale të barazisë gjinore. Instituti Evropian për Barazi Gjinore (IEBGJ), për shembull, liston 2,034 tregues të ndryshëm potencial të barazisë gjinore, jo të gjithë prej tyre mund të shqyrtohen në këtë punim.⁵ Për këtë punim, barazia gjinore ishte jetësuar duke përdorur dimensionet si më poshtë: pjesëmarrja politike, arsimit, punësimi, hendeku gjinor i pagave, varfëria, shëndeti dhe kujdesi ndaj fëmijëve. Pjesë e arsyes për zgjedhjen e këtyre dimensioneve të veçanta të barazisë gjinore ishte se ato përbënin tema të përsëritura që dolën nga literatura ekzistuese që ka të bëjë me anëtarësimin në BE dhe barazinë gjinore. Autorë të tjerë tanimë kishin shkruar lidhur me atë se si anëtarësimi i BE-së kishte apo mund të kishte ndikuar në kujdesin ndaj fëmijëve,⁶ punësimin,⁷ dhe shëndetësinë⁸ në vendin e tyre. Kjo ngjalli një interesim për të hetuar nëse këto zona ndoshta mund të preken si pjesë e procesit të anëtarësimit të Kosovës në BE. Arsyeja e dytë për përzgjedhjen e këtyre dimensioneve të veçanta të barazisë gjinore ishte se për masa të tjera, ekzistonte tendenca që të dhënat të mos jenë në dispozicion për periudhën e para-anëtarësimit, duke i bërë krahasimet të pamundura me kalimin e kohës; ose të dhënat ishin kontradiktore për shkak të metodologjive të ndryshme që janë përdorur në mbledhjen e të dhënave, gjithashtu duke penguar krahasimet e të dhënave me kalimin e kohës. Faktori i tretë që merrej parasysh gjatë përzgjedhjes së këtyre treguesve ishte rëndësia e tyre e mundshme për Kosovën në procesin e anëtarësimit në BE dhe disponueshmëria e të dhënave në Kosovë, që do të mundësonin një bazë për krahasim. Fillimisht këta tregues ishin përzgjedhur në lidhje me Strategjinë e RrGGK-së për 2015-2018, e cila bazohej në një proces me shumë pjesëmarrje të grupeve të grave në tërë Kosovën, ku u identifikuan fushat kryesore me interes për të drejtat e grave dhe barazinë gjinore. Këto u bënë fushat strategjike të fokusit për Strategjinë e RrGGK-së dhe kështu ishin në qendër edhe të këtij hulumtimi, pasi këto fusha konsiderohet të jenë më shqetësuese për aktivistët për të drejtat e grave dhe në nevojë të praktikave më të mira nga vende të tjera që kishin paraprirë Kosovën në anëtarësim në BE. Në këtë drejtim, përzgjedhja e këtyre dimensioneve të veçanta që lidhen me hulumtimet fillestare synojnë se gjetjet mund të përdoren për të karakterizuar procesin e anëtarësimit të Kosovës në BE. Më konkretisht masat e përdorura përfshijnë:

- **Pjesëmarrja politike:** e jetësuar si përqindje e ministrave në qeveritë nacionale që janë gra dhe burra; dhe përqindja e anëtarëve të parlamentit kombëtar që janë gra dhe burra. Përfaqësimi brenda partive politike dhe në nivel lokal, nuk janë shqyrtuar për shkak të të dhënave të pamjaftueshme në dispozicion me kalimin e kohës.

⁵ Baza e të Dhënave të Statistikave Gjinore, IEBGJ, qasur më 9 dhjetor 2016, në: <http://eige.europa.eu/gender-statistics/dgs/browse/ta>.

⁶ Fondacioni i Bullgarisë për Kërkime Gjinore, *Vlerësimi Gjinor i Ndikimit të Anëtarësimit në BE në Statusin e Grave dhe Tregun e Punës në EQL, Studim Kombëtar: Bullgari, Karat Coalition dhe UNIFEM*, Sofje: 2003

⁷ Michaela Marksova-Tominova, 'Vlerësimi Gjinor i Ndikimit të Anëtarësimit në BE në Statusin e Grave dhe Tregun e Punës në EQL, Studim Kombëtar: Republika Çeke, Karat Coalition dhe UNIFEM, Pragë: 2003.

⁸ Angelika von Wahl, 'BE-ja dhe Zgjerimi: Konceptualizimi përtej "Lindjes" dhe "Perëndimit" ', në *Politikën Gjinore në Zgjerimin e Bashkimit Evropian*, Silke Rothe (ed.).

- **Arsimi:** i jetësuar duke përdorur dy masa: përfundimin e arsimit të mesëm të lartë dhe të arsimit postsekondar jo të lartë përfundimin e arsimit të lartë.
- **Punësimi:** duke u fokusuar në normat e punësimit dhe papunësisë. Hulumtuesit u përpoqën që të analizojnë shkallën e punësimit të të rriturve sipas grupmoshave, nivelit të arritjeve arsimore, numrit të fëmijëve dhe moshës së fëmijës më të vogël, por nuk kishte të dhëna përpara vitit 2005. Përderisa dimensionet e tjera siç janë ndarja sipas sektorit gjinor, cilësia e punës ose aftësitë për të vendosur në lidhje me punën e dikujt mund të jenë pasqyrë e rëndësishme e barazisë gjinore, kufizimet kohore për analizën e të dhënave çoi ekipin e hulumtimit që të kufizojnë hulumtimin e punësimit në këto dy dimensione. Hulumtimet e ardhshme mund të shqyrtojnë të tjera.
- **Hendeku gjinor i pagave:** shqyrton 'dallimin në mes të pagës së burrave dhe grave, duke u bazuar në diferencën mesatare në të ardhurat bruto për orë të të gjithë punonjësve'.⁹ Të dhënat kishin ekzistuar në Eurostat nga 1994-2005. Megjithatë, metodologjia kishte ndryshuar në vitin 2005. Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OBEZH) ka pasur të dhëna prej vitit 2000 deri më sot, por kishte përdorur një metodologji tjetër. Në fund, janë përdorur të dhënat e Eurostatit.¹⁰
- **Varfëria** është matur duke përdorur shkallën në rrezik nga varfëria
- **Shëndeti** është matur duke përdorur dy dimensionet e shëndetit të vetë-perceptuar dhe nevojat e paplotësuara mjekësore.
- **Kujdesi ndaj fëmijëve** shqyrtoi përqindjen e fëmijëve me qasje në kujdesin ndaj fëmijëve, bazuar në Objektivat e Barcelonës të BE-së.

Fillimisht, janë marrë parasysh edhe dimensionet e dhunës në familje, ngacmimi seksual, pensionet dhe trafikimi seksual njerëzor. Megjithatë, më pas këto ishin hequr nga analiza për shkak të mungesës së të dhënave në nivel vendi, masave të ndryshueshme gjerësisht dhe/ose metodat e mbledhjes së të dhënave që e bënë të vështirë për të bërë krahasime në të gjitha vendet. Siç u përmend, ekzistojnë disa dimensionet e tjera të mundshme të barazisë gjinore që nuk janë shqyrtuar këtu, zakonisht për një arsye të ngjashme të të dhënave të padisponueshme, të krahasueshme me kalimin e kohës.

Përzgjedhjet e bëra në lidhje me afatin kohor të studiuar dhe mënyrën në të cilën është jetësuar barazia gjinore në mënyrë të qartë kufizojnë rezultatet e hulumtimit dhe përgjithësimin e tyre. Së pari, vendimi për të mos krahasuar të dhënat para procesit të para-anëtarësimit për shkak të mungesës së të dhënave dëmton në mënyrë të konsiderueshme aftësinë për të identifikuar ndikimin që proceset e para-anëtarësimit mund të ketë pasur në këta tregues. Së dyti, treguesit e përzgjedhur mund të mos jenë masat më të mira të barazisë gjinore. Lexuesit duhet t'i kenë kufizime në mendje.

I përfunduar në vitin 2016, ky hulumtim kishte përfshirë metoda të përziera, duke përfshirë: një rishikim të shpejtë të kuadrit përkatës ekzistues ligjor; hulumtim sekondar në lidhje me ndikimin që anëtarësimi në BE ka pasur në barazinë gjinore në vendet e tjera; analizat statistikore të treguesve kyç që kanë të bëjnë me barazinë gjinore; dhe konsultimet me aktivistët dhe zyrtarët në Kosovë.

Shumica e të dhënave erdhën nga Eurostat ose IEBGJ, përveç nëse është treguar ndryshe. Modelet e regresionit linear me efekt të përzier në vend si një ndryshore e rastit janë përdorur për të vlerësuar bashkëveprimin midis ndryshimeve të treguesve me kalimin e kohës sipas gjinisë dhe statusit të anëtarësimit në BE. Të gjitha modelet përfshinin një afat të bashkëveprimit ndërmjet gjinisë dhe statusit të BE-së. Në tërësi këtë punim, termi 'i rëndësishëm' tregon që është identifikuar një

⁹ Komisioni Evropian, Trajtimi i hendekut gjinor në Bashkimin Evropian, Luksemburg: 2013, p. 2. Pjesa tjetër e informtave në këtë paragraf i referohet të njëjtit raport, përveç nëse tregohet ndryshe.

¹⁰ Ky është treguesi i vetëm i shqyrtuar për të cilën Kosova nuk ka të dhëna, por është përzgjedhur duke marrë parasysh se Kosova së shpejti mund të jetë në gjendje të mbledhë të dhëna të tilla, si pjesë e përpjekjeve të saj për të vendosur Indeksin për Barazi Gjinore të BE-së. Konsiderohej i rëndësishëm edhe duke pasur parasysh historinë e saj në lidhje me BE-në.

marrëdhënie statistikiqst e rëndësishme në $p < 0.05$. Në disa raste, vendet demonstuan përmirësime në barazinë gjinore me kalimin e kohës, por nuk ekzistonte një marrëdhënie statistikiqst e rëndësishme në anëtarësimin në BE gjatë periudhës së shqyrtuar. Pasi ky studim u fokusua në ndikimin e mundshëm të anëtarësimin në BE, ishte përtej qëllimit të këtij studimi të veçantë për të shqyrtuar se si faktorë të tjerë jashtë anëtarësimin në BE mund të kenë ndikuar në këto ndryshime. Këto mund të jenë fusha për kërkime të mëtejshme.

Rreth këtij dokumenti

Ky punimi fillon me një histori të shkurtër të BE-së dhe aspiratave të Ballkanit Perëndimor për anëtarësim në BE.¹¹ Ai shqyrton shkurtimisht legjislacionin kryesor për barazinë gjinore të BE-së, duke u fokusuar në direktivat e BE-së relevante për Kosovën. Pastaj, punimi analizon pozitën e grave, burrave dhe barazisë gjinore para dhe pas anëtarësimin në BE, duke u fokusuar në dimensionet e lartpërmendura: pjesëmarrjen politike, arsimit, shëndetësia, varfëria, punësimi, hendekun gjinor të pagave dhe kujdesin ndaj fëmijëve.¹² Në çdo pjesë të këtij punimi, është paraqitur një pasqyrë e shkurtër e situatës aktuale në Kosovë që të sigurohet një kontekst se në çfarë mënyre Kosova krahasohet me vendet e BE. Aty ku ka qenë e mundur janë dhënë rekomandime apo konkludime logjike në lidhje me procesin e anëtarësimin të Kosovës në BE. Më pas, të dhënat sasiore janë në kontekst nga një rishikim i shkurtër i vlerësimeve kritike të procesit të anëtarësimin në BE dhe ndikimit të saj mbi barazinë gjinore në veçanti në disa shtete anëtare. Në fund, ky punim rishikon përfundimet që mund të nxirren nga ky hulumtim i veçantë, duke siguruar disa pika që duhet të mirren në konsideratë në procesin e anëtarësimin të Kosovës në BE.

Një histori e shkurtër e Bashkimit Evropian

Në vitin 1952, Belgjika, Franca, Gjermania Perëndimore, Italia, Luksemburgu dhe Holanda themeluan Traktatin Evropian të Qymyrit dhe Çelikut (ECSC), duke krijuar bazën fillestare për BE-në. Në vitin 1957, të njëjtat shtete themeluan Komunitetin Ekonomik Evropian (EEC). Danimarka, Irlanda dhe Mbretëria e Bashkuar (UK) u bashkuan në vitin 1973, të ndjekura nga Greqia (në vitin 1981), Portugalia dhe Spanja (në vitin 1986). Pastaj, Traktati i Mastrohitit krijoi BE-në në vitin 1993 dhe prezantoi qytetarinë evropiane. Dymbëdhjetë vendeve të lartpërmendura iu bashkua Suedia, Austria dhe Finlanda në vitin 1995.¹³ Në vitin 2004, dhjetë vende tjera iu bashkangjitën BE-së: Qipro, Republika Çeke, Estonia Hungaria, Letonia, Lituania, Malta, Polonia, Sllovakia dhe Sllovenia. Ky ishte anëtarësimi më i madh dhe zgjerimi i parë lindor. Bullgaria dhe Rumania u bashkangjitën në vitin 2007. Vendi që u anëtarësua së fundmi ishte Kroacia në vitin 2013, duke e rritur numrin e përgjithshëm të vendeve anëtare të BE-së në 28 që nga viti 2016.

Çdo vend që dëshiron të bëhet anëtare e BE-së duhet të jetë në përputhje me kushtet dhe parimet e përcaktuara në Traktatin për Bashkimin Evropian.¹⁴ Vendet duhet të përmbushin disa kritere për praninë. Këto kritere (të njohura si kriteret e Kopenhagës) janë:

¹¹ Termi "Ballkani Perëndimor" është përdorur ashtu si parlamenti i BE-së e përdor këtë term kur i referohet Kroacisë, Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Kosovës, Malit të Zi dhe Serbisë (European Parliament, 'Fact Sheets on the European Union: The Western Balkans', accessed 3 December 2016, at: http://www.europarl.europa.eu/atyourservice/en/displayFtu.html?ftuld=FTU_6.5.2.html).

¹² Përtej këtyre zonave në të cilat barazia gjinore është shqyrtuar këtu, ekzistojnë çështje të tjera të rëndësishme lundhur me barazinë gjinore, si dhuna në familje, ngacmimi seksual dhe pensionet. Megjithatë, të dhënat në dispozicion janë të pamjaftueshme për të mundësuar krahasimin e ndryshimeve që mund të kenë ndodhur para dhe pas anëtarësimin në BE.

¹³ Martin Sajdik dhe Michael Schwarzingger, *European Union Enlargement: Background, Developments, Facts*, 2008, fq. 6.

¹⁴ Traktati i Bashkimit Evropian, neni. 49 dhe 6(1).

stabiliteti i institucioneve që garanton demokracinë, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe respektimin dhe mbrojtjen e minoriteteve; një ekonomi funksionale e tregut dhe aftësinë për të përbashkuar presionin dhe forcat e tregut konkurrense brenda BE-së; aftësinë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit, duke përfshirë kapacitetin për të zbatuar në mënyrë efektive rregullat, standardet dhe politikat që përbëjnë trupin e ligjit të BE-së ('acquis'), dhe respektimin e qëllimeve të bashkimit politik, ekonomik dhe monetar.¹⁵

Anëtarësimi në BE në Rajonin e Ballkanit Perëndimor

Në vitin 2003, në Selanik u mbajt Samiti i BE-së për Ballkanin Perëndimor. Samiti mbledhi shtetet anëtare të BE-së, si dhe vendet kandidatë për anëtarësim në BE. U miratua një deklaratë e përbashkët në samitin që, ndër të tjera, mirëpriti miratimin e agjendës së Selanikut për Ballkanin Perëndimor. BE-ja përsëriti mbështetjen e tij për anëtarësimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE.¹⁶ Aktualisht, Shqipëria, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi, Serbia dhe Turqia janë kandidatë për anëtarësim në BE. Bosnja dhe Hercegovina ka dorëzuar zyrtarisht kërkesën e tyre për anëtarësim në shkurt të vitit 2016,¹⁷ ndërsa Kosova shihet si kandidat potencial. Megjithatë, Kosova mbetet e pasigurt në marrëdhëniet kontraktuale me BE-në pasi që pesë shtete anëtare të BE-së nuk e njohin shtetësinë e Kosovës.¹⁸

Acquis i BE-së për Barazi Gjinore

Sipas Susanne Burrit dhe Sacha Prechal, 'Termi "*Acquis* i BE-së për barazi gjinore" i referohet të gjitha dispozitave përkatëse të Traktatit, legjislacionin dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (GJED) në lidhje me barazinë gjinore'.¹⁹ Vendet duhet të kenë kapacitetin për të zbatuar në mënyrë efektive rregullat, standardet dhe politikat që përbëjnë *acquis* të BE-së për barazinë gjinore. Kjo pjesë përshkruan dispozitat kryesore të BE-së traktatit, legjislacionin dhe praktikën gjyqësore sipas *acquis* të BE-së për barazi gjinore, të cilat Kosova duhet të përpiqet t'i zbatojë:

- Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian përcakton parimet e pagës së barabartë për gra dhe burra.²⁰ Rregulli i vitit 1976 i GJED përcaktoi se ky parim nuk është vetëm ekonomik, por shoqëror,²¹ dhe mandej qëllimi i tij shoqëror merr përparësi mbi qëllimin e tij ekonomik.²² Gjykata më tej vendosi që paga e barabartë është e drejtë themelore e njeriut.²³

¹⁵ Eur Lex (qasja në ligjin e Bashkimit Evropian), 'Kriteret e pranimit (kriteret e Kopenhagenit)', në: http://eur-lex.europa.eu/summary/glossary/accession_criteria_copenhagen.html.

¹⁶ Kryetari i Samitit të Ballkanit Perëndimor në Paris, Deklarata nga Samiti i BE-së për Ballkanin Perëndimor, Selanik 2003.

¹⁷ Komisioni Evropian, "Deklaratë e përbashkët nga Përfaqësuesi i Lartë / Zëvendës-presidenti Federica Mogherini dhe Komisioneri Johannes Hahn, me rastin e paraqitjes së kërkesës për anëtarësimin e Bosnje dhe Hercegovinës", 2016.

¹⁸ Komisioni Evropian, 'European Neighbourhood Policy and Enlargement Negotiations: Kosovo', në: http://ec.europa.eu/enlargement/countries/detailed-country-information/kosovo/index_en.htm.

¹⁹ Susanne Burri dhe Sacha Prechal, *E Drejta e BE-së për Barazi Gjinore*, Azhurnuar në vitin 2013, p. 1.

²⁰ Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, Neni 157 (neni i mëparshëm 119 KEE, neni i mëparshëm 141 KE), 1958.

²¹ GJED, 8 prill 1976, Rasti 43/75 Gabrielle Defrenne v Société Anonyme Belge de Navigation Aérienne Sabena [1976] ECR 455 (Defrenne II).

²² GJED, 10 shkurt 2000, Rasti C-50/96 Deutsche Telekom AG, ish Deutsche Bundespost Telekom v Lilli Schröder [2000] ECR I-743 (Schröder).

²³ GJED, 15 qershor 1978, Case 149/77, Gabrielle Defrenne v Société Anonyme Belge de Navigation Aérienne Sabena [1978] I 365 (Defrenne III).

- Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, e cila ndër të tjera ndalon diskriminimin në bazë të gjinisë dhe njeh të drejtën e barazisë gjinore në të gjitha fushat²⁴
- Direktiva për pagë të barabartë për burra dhe gra (75/117) mbulon zbatimin e parimit të pagesës së barabartë për burra dhe gra, me qëllim të eliminimit të tërë diskriminimit në bazë të gjinisë në lidhje me pagesën.²⁵
- Traktati i Lisbonës nënvizon rëndësinë e mos-diskriminimit dhe barazisë si parimet themelore të së drejtës së BE-së.²⁶
- Direktiva për Trajtimin e Barabartë të Burrave dhe Grave në Punësim (76/207) kishte për qëllim të zbatojë në Shtetet Anëtare parimin e trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë 'në lidhje me qasjen në punësim, duke përfshirë gradimin, dhe trajnimin profesional, kushtet e punës dhe sigurimet sociale'.²⁷ Më vonë ajo u ndryshua me Direktivën 2002/73/EC4 të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë në qasjen në punësim, trajnimin profesional, gradim dhe kushtet e punës.
- Direktiva për Trajtimin e Barabartë të Burrave dhe Grave në Skemat e Sigurimit Social në Punë (86/378) ka për qëllim zbatimin në skemat e sigurimit social në punë të parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë.²⁸ Direktiva është ndryshuar më vonë me Direktivën 96/97/EC6 të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë në skemat e sigurimit social në punë.
- Direktiva për Barrën e Provës (97/80) me qëllim të sigurimit që masat e marra nga Shtetet Anëtare për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë janë bërë më efektive, 'për t'u mundësuar të gjithë personave që e konsiderojnë veten të dëmtuar për shkak se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre, të kërkojnë të drejtat e tyre në proceset gjyqësore pas ankimit të mundshëm pranë organeve të tjera kompetente".²⁹
- Direktiva për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave të angazhuar në një veprimtari në cilësi të vetë-punësuar ka për qëllim që të zbatojë parimin e trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave të vetëpunësuar.³⁰
- Direktiva për Punëtorët Shtatzëna (92/85/EEC) ka për qëllim që të mbrojë shëndetin dhe sigurinë e grave në vendin e punës', kur janë shtatzëna ose që kanë lindur rishtazi dhe grave të cilat janë gjdhënëse.³¹
- Direktiva 2000/43/EC për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht nga prejardhja racore apo etnike sipas të cilit 'gratë janë shpesh viktimat të diskriminimit të shumëfishtë'.³²

²⁴ Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (2000/C 364/01), neni 21 dhe 23, në:

http://www.europarl.europa.eu/charter/pdf/text_en.pdf

²⁵ Direktiva e Këshillit 75/117 /EEC e 10 shkurtit 1975 për përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare që lidhen me zbatimin e parimit të pagesës së barabartë për burra dhe gra

²⁶ Ministria e Jashtme në Londër, 'Tekstet e konsoliduara të Traktateve të BE-së të ndryshuara me Traktatin e Lisbonës', version i konsoliduar i Traktatit të Bashkimit Evropian, 2008, neni 2 në:

https://www.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/228848/7310.pdf.

²⁷ Direktiva e Këshillit 76/207/EEC e 9 shkurtit 1976 për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë në qasjen në punësim, trajnimin profesional, gradim dhe kushtet e punës.

²⁸ Direktiva e Këshillit 86/378 /EEC e 24 korrikut 1986 për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë në skemat e sigurimit social në punë.

²⁹ Direktiva e Këshillit 97/80 /EC e 15 dhjetorit 1997 për barrën e provës në rastet e diskriminimit të bazuar në gjini.

³⁰ Direktiva e Këshillit 86/613, e cila është shfuqizuar me Direktivën 2010/41, Përmbledhje e Direktivës 2010/41 / EU

³¹ Direktiva e Këshillit 92/85 /EEC e 19 tetorit 1992 për futjen e masave për të inkurajuar përmirësimet në sigurinë dhe shëndetin në punë të punëtorëve shtatzëna dhe punëtorëve që kanë lindur rishtazi ose janë gjdhënëse

³² Direktiva e Këshillit 2000/43 / EC e 29 qershorit 2000 për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike

- Direktiva për Pushimin Prindëror konkludon se të gjithë punëtorët, burrat dhe gratë, pavarësisht nga lloji i tyre i punës kanë të drejtë për pushim prindëror.³³
- Direktiva për Trajtimin e Barabartë të Burrave dhe Grave në Qasje në dhe Furnizimin e Mallrave dhe Shërbimeve (2004/113) krijon një kornizë për të trajtuar diskriminimin gjinor në qasjen dhe furnizimin e mallrave dhe shërbimeve në sektorin publik dhe privat.³⁴
- Direktiva 2006/54/EC për zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe profesionit hyri në fuqi në vitin 2009. Kjo direktivë është e njohur edhe si Direktiva e përpunuar, dhe iu bashkua direktivave ekzistuese në barazinë gjinore³⁵ Direktiva e Përmbledhur përcakton konceptet e diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, ngacmimit dhe ngacmimit seksual, si dhe çështjet e pagës së barabartë dhe trajtimit të barabartë. Ai përfshin dispozitat lidhur me mjetet juridike dhe dënimet, barrën e provës, e viktimizimit, promovimin e trajtimit të barabartë përmes organeve të barazisë, dialogut social dhe dialogut me organizatat joqeveritare (OJQ-të).³⁶
- Direktiva për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Mbrojtja e viktimeve të saj (2011/36 / EU) përcakton rregullat e përbashkëta për veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore dhe për ndëshkimin e shkelësve. Ajo gjithashtu siguron masa për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore për të forcuar mbrojtjen e viktimeve³⁷

Në mënyrë të veçantë, shumica e *acquis* së BE-së për barazi gjinore adreson trajtimin e barabartë dhe jo-diskriminimin në punë. Direktivat nuk merren në mënyrë eksplicite me fushat e tjera ku mund të ekzistojnë pabarazitë gjinore, siç janë ato në lidhje me arsimin dhe shëndetin. Kjo mund të nënkuptojë se miratimi dhe zbatimi i *acquis* së BE-së për barazi gjinore, si pjesë e procesit të anëtarësimit në BE nuk mund të ketë ndonjë ndikim në këta sektorë të veçantë. Përderisa ishte jashtë fushëveprimit të këtij punim që të ndërmarrë një rishikim tërësor të kornizës ligjore të Kosovës dhe përafritimit të saj me *acquis* të BE-së për barazi gjinore, kjo është një fushë e rëndësishme për kërkime të mëtejshme. *Acquis* e BE-së për barazi gjinore ofron një kornizë thelbësore dhe kontekst për të diskutuar procesin e anëtarësimit të Kosovës në BE nga pikëpamja e barazisë gjinore.

Kosova dhe anëtarësimi në BE

Kosova është në proces të anëtarësimit në BE. Kuvendi i Republikës së Kosovës ratifikoi MSA-në në nëntor të vitit 2015. Asnjë analizë gjinore nuk është kryer për të informuar hartimin e MSA-së; barazia gjinore dhe të drejtat e grave vështirë që shfaqen në përmbajtjen e saj.³⁸ Ministria e Integritimit Evropian (MIE) ka zhvilluar Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA), i cili është dokumenti kryesor i politikave që udhëheq punën e institucioneve të Kosovës drejt anëtarësimit në BE. Megjithatë, gjinia është integruar në mënyrë të pamjaftueshme brenda saj, dhe

³³ Direktiva e Këshillit 96/34, e cila është shfuqizuar me Direktivën 2010/118, Përmbledhje e Direktivës së Këshillit 2010/18 / EU

³⁴ Direktiva e Këshillit 2004/113 / EC e 13 dhjetorit 2004 për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave në qasjen dhe furnizimin e mallrave dhe shërbimeve.

³⁵ Kjo Direktivë inkorporoi Direktivën 76/207/EEC e ndryshuar me Direktivën 2002/73 / EC4 për trajtimin e barabartë për burrat dhe gratë në qasjen në punësim, trajnim profesional dhe gradimin dhe kushtet e punës, Direktiva 86/378 / EEC, e ndryshuar me Direktivën 96/97/EC6 për trajtimin e barabartë të burrave dhe grave në skemat e sigurimit social në punë, Direktiva 75/117/EEC për pagë të barabartë midis burrave dhe grave dhe Direktiva 97/80 / EC mbi barrën e provës (Susanne Burri dhe Sacha Prechal, *Transpozimi i Direktivës së përpunuar 2006/54 / EC, 2009*).

³⁶ Po aty.

³⁷ Direktiva 2011/36 /EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 5 prillit 2011 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimeve të tij, dhe duke zëvendësuar Vendimin Kornizë të Këshillit 2002/629 /JHA

³⁸ Dy referencat e vetme të grave në dokument kanë të bëjnë me mundësitë e barabarta (në punësim) dhe në kushtet e punës për gratë (neni 106). Nuk është përmendur asnjëherë barazisë gjinore

dokumenti nuk i kushton vëmendje të mjaftueshme të drejtave të grave. Në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore në Kosovë, të gjitha ligjet dhe politikat duhet të marrin parasysh nevojat dhe interesat e grave dhe burrave të ndryshëm.³⁹

Ndikimi i Anëtarësimit në BE në Barazi Gjinore


Në këtë pjesë përdoret analiza statistikore në disa tregues të ndryshëm të barazisë gjinore për të vlerësuar shkallën në të cilën anëtarësimi në BE mund të ketë kontribuar në barazinë gjinore në vendet anëtare të BE-së.⁴⁰ Vendet e Evropës Qendrore Lindore (CEE) dhe të Evropës Juglindore (SEE), vende që i janë bashkuar BE-së janë analizuar veçmas për të vlerësuar, nëse anëtarësimi në BE ka ndikuar në barazi gjinore ndryshe në këto rajone të veçanta. Vendet e EQL përfshijnë: Bullgarinë, Kroacinë, Republikën Çeke, Estoninë, Hungarinë, Letoninë, Lituaninë, Poloninë, Rumaninë, Sllovakinë dhe Slloveninë.⁴¹ Vendet e EJL janë përcaktuar të jenë: Bullgaria, Kroacia, Qipro, Greqia, Rumania dhe Sllovenia.⁴²

Në çdo pjesë ku përcillet pjesëmarrja politike, arsimi, punësimi, hendeku gjinor në paga, varfëria, shëndeti dhe kujdesin ndaj fëmijëve fillon me shqyrtimin se si anëtarësimi në BE mund të ketë ndikuar në barazinë gjinore në vendet që kanë hyrë në BE. Pastaj, situata aktuale në Kosovë në lidhje me këtë temë është përshkruar shkurtimisht, dhe nuk është nxjerrë ndonjë konkluzion relevant.

Pjesëmarrja politike

Një indikator i barazisë gjinore është pjesëmarrja e barabartë e grave në proceset politike, duke përfshirë edhe rolet vendimmarrëse.⁴³ Rritja e pjesëmarrjes së grave në këtë rast zakonisht shënon rritje të barazisë gjinore. Në vitin 2015, mesatarisht, femrat përbënin 26% të parlamenteve nacionale në BE. Gratë mbanin 28% të pozitave ministrore; dhe shtatë për qind të kryeministrave të shteteve

Figura 1. Gratë Përfaqësuese Nacionale sipas Anëtarësimit në BE Membership (%)



³⁹ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr 05/L-020 për Barazinë Gjinore, neni 5 (para. 1.3).

⁴⁰ Për më shumë informata në lidhje me metodologjinë, ju lutemi shikoni prezantimin. Për analizën e Shteteve Anëtare të BE-së' të progresit individual dhe të përbashkët drejt barazisë gjinore me kalimin e kohës, shih Barazia Gjinore e IEBGJ Indeksi në: <http://eige.europa.eu/rdc/eige-publications/gender-equality-index-2015-measuring-gender-equality-european-union-2005-2012-report>.

⁴¹ Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OBEZH) përfshin gjithashtu Shqipërinë në definicionin e saj të EQL (OBEZH, "Fjalor i Termave statistikore: Vendet e Evropës Qendrore Lindore", Azhurnuar më 2 nëntor 2001, në: <https://stats.oecd.org/glossary/detail.asp?ID=303>). Pasi Shqipëria ende nuk është një Shtet Anëtar, nuk kishte bazë për krahasim dhe kështu nuk është përfshirë në analizë.

⁴² Anastasios Karasavoglou, Serdar Ongan dhe Persefoni Polychronidou, *Kriza e BE-së dhe roli i periferisë, Zvicër*, 2015, f. 47.

⁴³ Të dhënat për këtë indikator janë marrë nga Unioni Ndërparlamentar, në: <http://www.ipu.org/english/home.htm>

anëtare ishin gra. Në shumicën e vendeve evropiane zbatohen kuotat gjinore të cilat ndryshojnë në dizajn dhe qëllim. Vendet që kanë aplikuar këto kuota kanë shënuar një rritje të dukshme të pjesëmarrjes së grave në politikë dhe kështu një rritje në barazinë gjinore. Nga të gjitha vendet që iu bashkuan BE-së pas vitit 2000, vetëm Bullgaria, Estonia dhe Letonia nuk kanë kuota gjinore në legjislacionin e tyre.


Në përgjithësi, kishte një rritje të përqindjes së grave në parlamentet nacionale (shih Figurën 1).⁴⁴ Mesatarisht, që nga viti 1997 përqindja e grave në parlamentet nacionale është rritur për 0.5 pikë përqindje në vit.⁴⁵ Megjithatë, gjatë periudhës së shqyrtuar, anëtarësimi në BE nuk duket të ketë pasur një ndikim të rëndësishëm në përfaqësimin e grave në parlamentet kombëtare në afat të shkurtër. Nuk ka pasur ndonjë ngritje të rëndësishme të përfaqësimit të grave që nga viti 2012. Siç ilustron Figura 1, gratë dhe burrat mbesin të pabarabartë në parlamentet nacionale.

Disa vende të Evropës Lindore kanë dëshmuar një rënie në pjesëmarrjen e grave në parlamentet kombëtare. Për shembull, aktualisht pjesëmarrja e grave në parlamentin bullgar është 20.4%, që shënon një rënie të lehtë nga 21.4% në vitin 2007 kur Bullgaria iu bashkua BE-së, si dhe një rënie të konsiderueshme që nga viti 2001, kur gratë përbënin 26.2% të parlamentit. Pasi Rumania u anëtarësua në BE në vitin 2007, pjesëmarrja e grave në Dhomën e Deputetëve u rrit prej 9.4% në vitin 2007 në 13.7% në vitin 2015. Megjithatë, pjesëmarrja e grave në Senat kishte rënë nga 10.2% në 7.7%. Edhe pse numri i përgjithshëm i grave që konkurojnë në zgjedhjet parlamentare të Kroacisë u rrit nga 24% e kandidatëve në vitin 2000 në 41% në vitin 2015, në nëntor të vitit 2015 gratë morën vetëm 15.2% të vendeve.⁴⁶ Kroacia nuk e ka pasur këtë pjesëmarrje të ulët së grave nga viti 1999, kur gratë i përbënin 7.9% të parlamentit. Megjithatë, në përgjithësi, pjesëmarrja e grave në parlamentet kombëtare nuk ishte shumë e ndryshme pas bashkimit me BE-në.

Përfaqësimi i grave në ministri ka mbetur mjaft i qëndrueshëm nga viti 2005 deri në vitin 2012.⁴⁷ Mesatarisht, 77% e ministrave kanë qenë meshkuj dhe 23% kanë qenë femra në BE. Përfaqësimi i grave në mesin e ministrave është dukshëm më i ulët në EQL dhe vendet e EQL, ku, mesatarisht, 17% e ministrave kanë qenë femra.

Gratë në Kosovë vazhdojnë të jenë të nën-përfaqësuar në pozita vendimmarrëse. Aktualisht, gratë mbajnë 32.5% të vendeve në parlament. Vetëm tri gra shërbejnë si ministra, nga 21 (14%). Nga 33 kryetarë të komunave, vetëm një është grua. Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme ka një kuota gjinore, sipas së cilës kërkohet që gratë dhe burrat, të përbëjnë 30% të të gjithë kandidatëve në listat e kandidatëve të partive politike.⁴⁸ Ky ligj nuk është në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore i cili parasheh

Figura 2. Përfaqësimi ministror sipas gjinisë në vendet e EQL



⁴⁴ Kjo analizë bazohet në të dhënat nga vendet e mëposhtme: Qipro, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Malta, Polonia, Sllovakia, Sllovenia, Bullgaria, Rumania dhe Kroacia.

⁴⁵ Një "pikë përqindje" është diferenca midis dy përqindjeve.

⁴⁶ Hina, 'Kroacia renditet e 92-a sipas përqindjes së grave në parlament, Evropë Ballkan Lajmet e fundit, korrik 2016, në: <https://eblnews.com/news/croatia/croatia-ranked-92nd-percentage-women-parliament-30658>.

⁴⁷ Kjo analizë bazohet në të dhënat nga vendet e mëposhtme: Austria, Belgjika, Bullgaria, Kroacia, Qipro, Republika Çeke, Danimarkë, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Irlanda, Italia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Malta, Holanda, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia dhe Mbretëria e Bashkuar.

⁴⁸ Ligji Nr. 03/L-073 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 27.

pjesëmarrjen e barabartë të burrave dhe grave në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në jetën politike dhe publike, të përcaktuar si 50%/.⁴⁹

Si përfundim, BE-ja nuk ka politika të detyrueshme në lidhje me pjesëmarrjen e grave në politikë. Anëtarësimi me BE në vetvete, kur studihet në këtë afat kohor, nuk duket të ketë rritje të barazisë gjinore sa i përket pjesëmarrjes politike. Kosova tashmë ka një kuadër ligjor në vend në drejtim të rritjes së avancimit të barazisë gjinore në pjesëmarrjen politike. Harmonizimi më i mirë i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme me Ligjin për Barazi Gjinore mund të kontribuojë në nxitjen e mëtejshme të pjesëmarrjes së grave në politikë, duke përfshirë edhe në pozita vendimmarrëse.

Arsimimi

Kjo pjesë shqyrton barazinë gjinore sa i përket qasjes në arsim. Para anëtarësimit në BE, mesatarisht 51.3% e grave kishin arsim të mesëm të lartë.⁵⁰ Pas anëtarësimit në BE, kjo u rrit pak deri 51.8%. Për burra, përqindja mesatare me shkollë të mesme para anëtarësimit në BE ishte 56.4% dhe pas anëtarësimit ishte 58.3%. Më pak gra kishin shkollim të mesëm të lartë sesa burra; mesatarisht, gratë ishin më ulët për 5.1 për qind pika sesa burrat. Në përgjithësi, nuk kishte ndonjë ndryshim të rëndësishëm gjatë kësaj periudhe kohore në përqindjen e grave dhe burrave me arsim të mesëm të lartë.

Duke shikuar vende të veçanta që nuk janë përfshirë në analizën e lartpërmendur statistikore ose Figurën 3 më sipër, Greqia, Italia, Luksemburgu, Portugalia dhe Mbretëria e Bashkuar kanë pasur të paktën një rritje prej 10% në përqindjen e grave me arsim të shkollës së mesme të lartë që nga viti 1995. Megjithatë, është e paqartë nëse kjo mund t'i atribuohet anëtarësimit në BE, pasi që këto vende iu bashkuan me BE-së para vitit 1995, dhe të dhënat më përpara nuk ishin ekzaminuar në analizë.

Ky trend ishte i ngjashëm për vendet e EQL. Mesatarisht, përqindja e grave me arsim të shkollës së mesme të lartë ishte për 6.9 pikë përqindjeje më e ulët se burrat. Pas bashkimit me BE-në, përqindja me shkollën e mesme të lartë ishte mesatarisht për 1.6 pikë përqindjeje më e lartë. Megjithatë, ky ndryshim ishte më i dukshëm për burrat sesa për gratë. Për gratë, përqindja mesatare me shkollë të mesme të lartë para anëtarësimit në BE ishte 55.4% dhe pas anëtarësimit në BE ishte 55.9%. Për burra, përqindja mesatare me shkollë të mesme të lartë

Figura 3. Përqindja e vlerësuar e qytetarëve me shkollim të mesëm të lartë sipas gjinisë dhe anëtarësim në BE





Figura 4. Arsimi i lartë sipas gjinisë dhe anëtarësim në BE



⁴⁹ Ligji për Barazi Gjinore, neni. 3 (I.10).

⁵⁰ Kjo analizë bazohet në të dhënat nga vendet e mëposhtme: Bullgaria, Kroacia, Qipro, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Malta, Polonia, Rumania, Sllovakia dhe Sllovenia

para anëtarësimit në BE ishte 61.6% dhe pas anëtarësimit në BE ishte 63.2%. Kjo sugjeron se hendeku midis grave dhe burrave është rritur paksa gjatë periudhës së hulumtuar.

Të paktën që nga viti 1996, gratë kanë përfaqësuar shumicën e të diplomuarve universitarë në BE. Ka pasur një rritje në përqindjen e grave me arsim të lartë në BE. Më tej, përqindja e grave me arsim të lartë është rritur më shpejt se ajo e burrave. Karakteristikë interesante është se Qiproja, ku shkalla e grave që kanë kryer arsimin e lartë është dyfishuar nga 31.5% në vitin 2000 në 60.5% në vitin 2015. Megjithatë, në vendet e hulumtuara, në mesatare nuk kishte dallim të madh në përqindjen e personave me arsim të lartë në periudhën kohore vetëm para dhe pas anëtarësimit në BE. As vendet e EJL dhe as ato të EQL nuk kishin dallim të madh statistikor në rritjen e arsimit të lartë që dukej të kishte të bënte me anëtarësim në BE në afatin e shkurtër. Hendeku ndërmjet grave dhe burrave duket të jetë zgjeruar gjatë periudhës së studiuar.

Përderisa kjo nuk është studiuar me kalimin e kohës, tani gratë mbeten të mbi-përfaqësuar veçanërisht në sektorët që lidhen me rolet tradicionale sociale të grave, siç janë shëndetësia, mirëqenia, shkencat humane, artet, mësimdhënia dhe shkollimi.⁵¹ Në vitin 2012, meshkujt përbënin shumicën e të diplomuarve në inxhinieri, prodhim dhe ndërtimtari. Pjesëmarrja e grave dhe burrave është më e balancuar në bujqësi dhe veterinari.

Kosova ka nivele shumë më të ulëta të arsimit se mesatarja e BE-së. Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, 31.3% e kosovarëve kanë përfunduar shkollën e mesme të lartë ose shkollim shtesë, rreth 15 pikë përqindje më pak se mesatarja e vitit 2015. Më tej, hendeku gjinor midis grave dhe burrave është më i gjerë në Kosovë sesa në BE; së paku 39.8% e meshkujve kanë përfunduar shkollimin e mesëm në krahasim me 22.7% të femrave. Që nga viti 2011, vetëm 4.9% e popullsisë së Kosovës ka pasur një diplomë bachelor, master ose doktoraturë, duke përfshirë 6.0% të meshkujve dhe 3.8% të femrave.⁵² Në vitin akademik 2015/2016, rreth 45.8% e studentëve aktivë në universitetet publike të Kosovës ishin meshkuj dhe 54.1% ishin femra. Në kolegjet private, 41,7% e studentëve ishin femra dhe 58.2% meshkuj.⁵³ Ndërkohë, kjo ndryshon pak nga viti në vit dhe sipas universiteteve, femrat duket se diplomojnë në universitete publike me norma më të larta se meshkujt.⁵⁴ Për shembull, gjatë viteve akademike 2012-2015, më shumë femra (57%) u diplomuan në universitetin më të madh publik të Kosovës, Universitetin e Prishtinës, se sa meshkuj (43%).⁵⁵

Sikurse në BE, disa programe arsimore mbeten të ndara sipas gjinisë. Për shembull, në vitet e fundit në Universitetin e Prishtinës, femrat vazhdimisht kanë përbërë shumicën e të diplomuarve në filozofi, filologji, ekonomi dhe mjekësi, ndërsa meshkujt përbënin shumicën në arkitekturë, inxhinieri, bujqësi dhe sporte.⁵⁶ Trende të ngjashme ekzistojnë në universitete të tjera publike të Kosovës. Nëse një bilanc i grave dhe burrave nuk janë të kualifikuar në të gjitha profesionet, kjo mund të kontribuojë në barazinë gjinore të pamjaftueshme brenda sektorëve të veçantë, ku gratë apo burrat janë të nën-përfaqësuar.

BE-ja ka kompetenca të kufizuara në çështjet që lidhen me arsimin, që është përgjegjësi e qeverive kombëtare. Kjo mund të shpjegojë pjesërisht pse anëtarësimi në BE nuk duket se lidhet me përmirësimet në arritjet arsimore, të paktën për periudhën kohore të studiuar. Megjithatë, në raport me politikat e punës dhe të punësimit, BE-ja mund të jetë në gjendje të ndikojë gjithashtu në ndryshime në arsim. Në Kosovë, BE-ja ka ndikim nëpërmjet Raportit të Vendit. Në Raportin e Vendit të Kosovës të vitit 2015, Komisioni Evropian (KE) ka identifikuar mungesën e transparencës, politizimin institucional

⁵¹ IEBGJ, "Pekin +20: Platforma për Veprim (BPfA) dhe Bashkimi Evropian, Zona B: Arsimi dhe Trajnimi i Grave", qasur më 3 dhjetor 2016, në http://eige.europa.eu/sites/default/files/documents/B_MH0415022ENC.pdf.

⁵² Llogaritur nga RrGGK Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), regjistrimi 2011, 'të dhënat e ASK: regjistrimi 2011'.

⁵³ Përqindja e studentëve të regjistruar aktualisht është llogaritur bazuar në të dhënat nga universitetet publike në vijim: Peja, Prishtina, Mitrovica, Gjilan, Gjakova dhe Prizreni. RrGGK ka llogaritë në bazë të të dhënave të ASK, *Statistikat arsimore në Kosovë 2015/2016*.

⁵⁴ Donjeta Morina dhe Nicole Farnsworth për RrGGK, *Buxhetimi për Arsim më të Mirë*, Prishtinë: RrGGK, 2016.

⁵⁵ ASK, *Statistikat Arsimore 2012/2013, 2013/2014 dhe 2014/2015*.

⁵⁶ Morina dhe Farnsworth për RrGGK, *Buxhetimi për Arsim më të Mirë*.


dhe mospërputhjen në mes të fushave të arsimit dhe nevojave të tregut të punës si problemet me të cilat përballet sistemi arsimor i Kosovës.⁵⁷ Për më tepër, si pjesë e procesit të anëtarësimit në BE, BE-ja siguron fonde për të mbështetur reformat, duke përfshirë në drejtim të adresimit të çështjeve të identifikuara në Raportin e Vendit. Në Kosovë, Instrumenti i Para-Anëtarësimit (IPA) mund të financojë programe në lidhje me sektorin e arsimit në Kosovë. Duke pasur parasysh ndarjen e tanishme gjinore në programet arsimore, mbështetja e tillë mund të përfshijë programe për të nxitur balancin e përmirësuar gjinor në programet ku gratë apo burrat janë të nën-përfaqësuar.

Punësimi

Edhe pse normat e punësimit ndryshojnë në të gjithë shtetet anëtare të BE-së, shkalla e përgjithshme e punësimit të grave është rritur në mënyrë të konsiderueshme me një mesatare prej 0.4 pikë përqindjeje në vit. Prandaj, normat e punësimit për gra pas anëtarësimit në BE ishte mesatarisht për 1.3 pikë të përqindjes më e lartë se para anëtarësimit. Megjithatë, normat e punësimit për femra janë vazhdimisht më të ulëta se sa për meshkuj. 28 Shtete Anëtare të BE-së, që nga viti 2014, norma e punësimit të grave ishte mesatarisht 59.6% në krahasim me 70.1% për meshkuj.⁵⁸ Mesatarisht, normat e punësimit për femra janë për 15.2 pikë të përqindjes më ulët se sa për meshkuj. Nuk kishte ndryshim të madh në norma të punësimit ndryshim esencial në diferencën ndërmjet normave të punësimit të grave dhe burrave.


Për vendet e EJT-së që janë bërë Shtete Anëtare, mesatarisht gjatë të gjitha viteve, normat e punësimit për gra ishin për 11.3 pikë përqindje më të ulëta se sa për burra. Mesatarisht, normat e punësimit pasi vendet e EJT-së iu bashkuan BE-së ishin për 3.4 pikë përqindje më të larta. Për vendet e EJT, nuk kishte ndryshime statistikore të mëdha në hendekun mes grave dhe burrave përpara dhe pas hyrjes në BE. Për vendet e EJT që janë bërë shtete anëtare, mesatarisht normat e punësimit

Figura 6. Norma e punësimit sipas gjinisë dhe anëtarësimit në Membership



nga periodha pak para anëtarësimit në BE.⁵⁹ Nuk kishte as

Figura 5. Normat e punësimit në Poloni



⁵⁷ KE, *Kosovë* 2015 Raporti*, Bruksel: EC, 2015, p. 46.

⁵⁸ Eurostat, 'Statistikat e punësimit', qasur më 3 dhjetor 2016 në: http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Employment_statistics.

⁵⁹ Bazuar në analizën e vendeve si në vijim: Bullgaria, Kroacia, Qipro, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Malta, Polonia, Rumania, Sllovakia dhe Sllovenia

për gra ishin 10 pikë përqindje më të ulëta se burrat.

Vende të veçanta, siç janë Polonia, Lituania, Letonia dhe Sllovakia kanë dëshmuar një rritje të normave të punësimit të femrave dhe e meshkujve që nga hyrja në BE. Në Rumani, norma e punësimit për meshkuj u rritën pak pasi Rumania u anëtarësua në BE nga 64% në vitin 2007 në 69.5% në vitin 2015. Megjithatë, në të dyja vendet, si në Rumani po ashtu edhe në Slloveni normat e punësimit të grave kanë mbetur të qëndrueshme. Në Bullgari, shkalla e punësimit të grave është rritur pak nga 57.6% në vitin 2007 në 59.8% në vitin 2015.

Trendët e tjerë ekonomikë mund të kenë dëmtuar ndikimin që anëtarësimi në BE mund të ketë pasur në barazinë gjinore në punësim. Për shembull, në Poloni, shkalla e punësimit ka rënë gjatë periudhës para anëtarësimi në BE (shih Figurën 6). Kur Polonia u bë anëtare (2004), shkalla e punësimit ishte 46.2% për femra dhe 57.2% për meshkuj. Që nga atëherë, normat e punësimit janë rritur në 56.6% për femra dhe 69.2% për meshkuj. Kështu, deri në vitin 2008, normat e punësimit duket të jenë ngritur në nivelin e njëjtë si në vitin 1998 dhe që nga atëherë janë ngritur vazhdimisht. Megjithatë, nuk ka diferencë të madhe statistikore në punësim para dhe pas bashkimit me BE-në, sepse mesatarisht, në përgjithësi, norma e punësimit e Polonisë ka mbetur e ngjashme.


Mënyra në të cilën normat e papunësisë kanë ndryshuar me kalimin e kohës dallonin në bazë të anëtarësimi në BE.⁶⁰ Megjithatë, në përgjithësi, normat e papunësisë nuk kanë qenë shumë të ndryshme për vendet që iu bashkuan BE-së. Shkalla e papunësisë për femra në BE nuk ishin shumë të ndryshme nga ato të femrave në vendet që ende nuk ishin anëtarësuar në BE. Për vendet e Evropës Juglindore dhe Evropës Qendrore dhe Lindore, nuk kishte një ndryshim të rëndësishëm në shkallën e papunësisë me kalimin e kohës në bazë të anëtarësimi në BE. Normat e papunësisë, mesatarisht, nuk ndryshonin sipas gjinisë.

Normat e papunësisë në vitin 2000 në shtetet e BE-së ishte mesatarisht 10% për femra dhe më pak se tetë për qind për meshkuj. Pas vitit 2008, kishte një rritje të përgjithshme të normave të papunësisë, ndoshta për shkak të krizës më të gjerë ekonomike. Megjithatë, deri në fund të vitit 2013, normat e papunësisë në mesin e grave dhe burrave në BE kishin prirje për ulje, duke arritur në 8.9% për femra dhe 9.2% për meshkuj deri në fund të vitit 2015.⁶¹ Kështu, hendeku gjinor në mes të femrave dhe meshkujve në lidhje me papunësinë ishte zvogëluar.

Kosova ka shkallën më të ulët të punësimit të femrave në Evropë: 11.3% e femrave dhe 38.7% e meshkujve ishin të punësuar në Kosovë në vitin 2015.⁶² Norma e papunësisë për femra ishte 36.6% dhe 31.8% për meshkuj në vitin 2015.⁶³ Më shumë të reja janë të papunë (67.2%) se sa të rinj (54.2%).⁶⁴

Në përfundim, anëtarësimi në BE, deri më sot, nuk ka pasur një ndikim të rëndësishëm në normat e punësimit për femra dhe meshkuj, dhe as në ngushtimin e hendekut në mes të normave

Figura 7. Normat e papunësisë



⁶⁰ Bazuar në analizën e vendeve si në vijim: Austria, Bullgaria, Kroacia, Qipro, Republika Çeke, Estonia, Finlanda, Hungaria, Letonia, Lituania, Malta, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovakia, Slloveni dhe Suedia.

⁶¹ Eurostat, 'Statistikat e punësimit' në http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Employment_statistics.

⁶² ASK, *Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore të Kosovës 2015*, Prishtinë: 2016 f. 11.

⁶³ Po aty, fq. 21.

⁶⁴ Po aty, fq. 22.

përkatëse të punësimit të femrave dhe meshkujve. Megjithatë, pabarazia midis normave të papunësisë së femrave dhe meshkujve duket se ka rënë gjatë periudhës së hulumtuar. Pjesë e arsyes se pse është e vështirë t'i atribuohen ndryshimet e normave të punësimit anëtarësimit në BE është se ka shumë pak të dhëna në dispozicion për periudhën para anëtarësimit. Përveç kësaj, këto vende kanë pasur luhajtje natyrore, dhe situata më e gjerë ekonomike globale gjithashtu mund të ketë ndikuar në normat e punësimit. Për shembull, efektet e rënies janë mjaft të dukshme në disa vende. Ndikimi i krizës ekonomike të vitit 2008 ndoshta garanton studim të mëtejshëm në lidhje me ndikimin që ka pasur për femrat, meshkujt dhe barazinë gjinore.

Hendeku gjinor i pagave

Siç u shpjegua, hendeku gjinor i pagave, siç përkufizohet nga KE-ja është 'diferenca midis pagës së meshkujve dhe femrave, në bazë të diferencës mesatare në të ardhurat për orë bruto të të gjithë punonjësve'.⁶⁵ Ndikimi i hendekut gjinor të pagave është afatgjatë, pasi kjo do të thotë se gratë fitojnë më pak gjatë jetës së tyre, gjë që mund të ndikojë në mirëqenien e tyre më vonë në jetë. Më shumë se 50 vjet më parë, Traktati i Romës sanksionoi parimin e pagesës së barabartë për femra dhe meshkuj. Edhe pse BE-ja ka miratuar shumë politika, strategji dhe legjislacion për këtë qëllim, prapë mbetet larg nga mbyllja e hendekut të gjinor të pagave.⁶⁶ Mesatarisht, femrat në BE marrin 16% më pak pagë se meshkujt për çdo orë të punës. Hendeku gjinor ndryshon nga vendi në vend. Në Slloveni, Maltë, Poloni, Luksemburg, Itali dhe Belgjikë mbetet nën 10%. Megjithatë, në vendet si Gjermania, Austria, Sllovenia, Estonia dhe Republika Çeke është mbi 20%.

Vendet që iu bashkuan BE-së pas vitit 2000 (EU13) nuk kanë pasur rënie drastike të hendekut gjinor të pagave.⁶⁷ Nga viti 2006 deri në vitin 2014, hendeku gjinor mesatarisht ka rënë 0.2% në vit (p < 0.001). Mesatarisht, nuk ka pasur ndonjë ndryshim të dukshëm nga viti 2012 deri në vitin 2014. Vendet me përmirësime më të mëdha ishin Qipro, Holanda, Sllovenia dhe MB. Edhe pse hendeku i përgjithshëm gjinor i pagave është ngushtuar në dekadën e fundit, në disa vende ai është rritur, siç janë Portugalia dhe Kroacia.⁶⁸ Në Hungari, hendeku i pagave kishte një rritje shqetësuese graduale nga 14.4% në vitin 2006 në 20% në vitin 2012. Megjithatë, në dy vitet e fundit, hendeku ka rënë në 15%. Në vende të tjera, siç është Estonia, hendeku gjinor i pagave ka mbetur pak a shumë i njëjtë gjatë dhjetë viteve të fundit. Për vendet që u anëtarësuan pas vitit 2000, hendeku i pagave ka rënë mesatarisht 2.6% në vit (p = 0.001). Ndoshta Direktivat e BE-së që kanë të bëjnë me pagesë të barabartë për punë të barabartë mund të kenë pasur një ndikim pozitiv, edhe pse është e vështirë të konkludojmë nëse domosdoshmërisht ekziston ndonjë lidhje shkakësore.

Kosova nuk ka të dhëna në lidhje me hendekun gjinor të pagave që do të mundësonte ndonjë krahasim. Kjo është një fushë ku Kosova ka nevojë për të përmirësuar mbledhjen dhe publikimin e statistikave në lidhje me barazinë gjinore.

⁶⁵ Komisioni Evropian, *Trajtimi i hendekut gjinor në Bashkimin Evropian*, Luksemburg: 2013, f. 2. Pjesa tjetër e informatave në këtë paragraf i referohet të njëjtit raport, përveç nëse tregohet ndryshe.

⁶⁶ Witkowska ka gjetur edhe një gamë të gjerë të pabarazisë në paga midis meshkujve dhe femrave, në profesione të ndryshme, nivele të arsimit dhe vendeve në BE, duke konkluduar se situata nuk është përmirësuar me shpejtësi, pavarësisht monitorimit nga institucionet e BE-së (Dorota Witkowska, "Pabarazitë gjinore në tregun e punës së BE-së", *Përparimet Ndërkombëtare në Kërkime Ekonomike*, 19: 4, nëntor 2013, f 331-334)..

⁶⁷ Analiza e RrGGK-së bazuar në të dhënat statistikore nga Eurostati. Vendet e përfshira në analizë ishin: Bullgaria, Republika Çeke, Kroacia, Qipro, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Malta, Polonia, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Austria, Belgjika, Danimarka, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Irlanda, Italia, Luksemburgu, Holanda, Portugalia, Spanja, Suedia dhe Mbretëria e Bashkuar.

⁶⁸ Komisioni Evropian, *Trajtimi i hendekut gjinor në Bashkimin Evropian*, 2014.

Varfëria


Në vitin 2015, rreth 17% e popullsisë së BE-së ishte në rrezik nga varfëria,⁶⁹ me femrat me një rrezik pak më të lartë të varfërisë se sa meshkujt. Kjo shpjegohet pjesërisht me faktin se, në të gjithë Evropën, gratë marrin pagë më të ulët dhe punojnë në kushte më të varfra të punës se sa meshkujt; gratë kanë më shumë gjasa sesa burrat që të kenë punë me gjysmë orar, kontrata afat të caktuar, ose mungesë e kujdesit lidhur me fuqinë punëtore.⁷⁰ Moshë është një faktor i rëndësishëm për të qenë në rrezik nga varfëria. Të rinjtë të moshës 16-24 janë në rrezik më të madh të varfërisë, sidomos femrat e reja në këtë grup moshë. Femrat e moshuara (mbi 65 vjeç) janë shumë më të rrezikuara nga varfëria sesa meshkujt e moshuar.⁷¹ Të qenurit i vetëm, veçanërisht një prind i vetëm, e rrit rrezikun e varfërisë. Pjesëmarrja relativisht e ulët e grave në aktivitete ekonomike është gjithashtu një faktor i rëndësishëm që i vendos femrat në rrezik më të lartë të varfërisë.⁷²

Me këtë analizë ishte zbuluar se rreziku i varfërisë ka qenë dukshëm më i madh për femra sesa për meshkuj.⁷³ Mesatarisht rreziku i varfërisë ka qenë 1.1 pikë përqindje më e lartë për femra. Në përgjithësi, pas anëtarësimit në BE, normat e rrezikut nga varfëria ishin mesatarisht për 2.1 pikë përqindjeje më e lartë. Megjithatë, nuk kishte të dhëna në dispozicion për vitin 2003 dhe të dhëna shumë minimale për vitin 2004. Pasi që disa vende iu bashkuan BE-së në vitin 2004, është e vështirë të thuhet nëse rreziku i normave të varfërisë ishte rritur me kalimin e kohës, para anëtarësimit në BE.

Për vendet e EJT, normat e rrezikut nga varfëria për femra ishte mesatarisht 1.7 pikë përqindje më e lartë se për meshkuj. Për periudhën e studiuar, nuk ka pasur një ndryshim të rëndësishëm në normat e varfërisë, pas anëtarësimit në BE. Nuk kishte asnjë ndryshim në normat e varfërisë sipas gjinisë pas anëtarësimit në BE. Për vendet e EQL, nuk kishte dallim të rëndësishëm statistikor në normat e varfërisë sipas gjinisë dhe nuk kishte ndryshim në normat e varfërisë, pas anëtarësimit në BE.

Në Kosovë, normat e varfërisë mbesin të larta. Përafërsisht 40% e popullsisë jetonte nën linjën e varfërisë në vitin 2013 dhe 10% në varfëri të skajshme.⁷⁴ Burrat dhe gratë që jetojnë në zonat rurale janë më të prekur, duke përbërë 65% të personave të varfër në Kosovë.⁷⁵ Pak më shumë femra jetojnë në varfëri (30.3%) sesa meshkuj (29.2%). Gratë kryefamiljare kanë norma më të larta të varfërisë (39.8%) se familjet e drejtuara nga burrat (29%). Varfëria e skajshme është në mënyrë disproporcionale më e lartë në mesin e fëmijëve, të moshuarve, familjeve me anëtarë me aftësi të kufizuara, familjeve të grave kryefamiljare dhe të disa familjeve të pakicave etnike, veçanërisht në mesin e romëve, ashkalive

Figura 8. Në rrezik nga varfëria



⁶⁹ Eurostat Zyra e shtypit, "Komunikatë për shtyp: Pjesa e personave në rrezik nga varfëria apo përjashtimi social në BE kthehet në nivelin e tij para krizës", 2016.

⁷⁰IEBGJ, "Pekin +20: Platforma për Veprim (BPfA) dhe Bashkimi Evropian Zona A: Gratë dhe Varfëria'.

⁷¹ Po aty.

⁷² Po aty.

⁷³ Bazuar në analizën e vendeve si në vijim: Bullgaria, Kroacia, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Malta, Polonia, Rumania dhe Sllovenia.

⁷⁴ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), *Vlera e Vërtetë e Asistencës Sociale*, Prishtinë: UNDP, 2014.

⁷⁵ Ulf Färnsveden, Ariana Qosaj-Mustafa, Nicole Farnsworth, *Kosovë Profili Gjitor i Vendit*, Prishtinë: Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar, 2014, f. 18.

dhe egjiptianëve.⁷⁶ Kjo analizë tregon se anëtarësimi në BE nuk ndihmon domosdoshmërisht Kosovën në uljen e normave të saj shqetësuese të varfërisë, të paktën jo menjëherë.


Shëndetësia

Organizimi dhe sigurimi shëndetësor është përgjegjësi e qeverive kombëtare. Roli i BE-së është që të plotësojë politikat kombëtare duke ndihmuar qeveritë e Shteteve Anëtare për të arritur objektivat e tyre të përbashkëta. Politika shëndetësore e BE-së përqendrohet në: 'parandalimin, sidomos duke promovuar mënyrë më të shëndetshme të jetës, mundësi të barabarta për shëndet të mirë dhe kujdes cilësor shëndetësor për të gjithë (pavarësisht nga të ardhurat, gjinia, përkatësia etnike, etj), trajtimin e kërcënimeve serioze shëndetësore që përfshin më shumë se një vend të BE-së, duke i mbajtur njerëzit të shëndetshëm në moshën e vjetër, mbështetjen e sistemeve shëndetësore dinamike dhe teknologjive të reja'.⁷⁷

Në këtë pjesë nuk mund të krahasohen të dhënat para vitit 2005 dhe pas anëtarësimit në BE për shkak të mungesës së të dhënave në dispozicion për periudhën para vitit 2005. Megjithatë, diskutimi i qasjes në kujdesin shëndetësor dhe shëndetin e perceptuar të qytetarëve është i vlefshëm, pasi që kjo është identifikuar si prioritet nga gratë në Kosovë.⁷⁸

Qasja në kujdesin shëndetësor mund të përkufizohet si përqindja e njerëzve të cilët gjatë 12 muajve të fundit kanë pasur nevojë për kujdes shëndetësor dhe e kanë kërkuar atë. Në të kundërtën, përkufizimi i 'nevojave të paplotësuara mjekësore' përfshin përqindjen e njerëzve që kishin nevojë për trajtim mjekësor në 12 muajt e fundit, por nuk e kanë kërkuar atë. Në vitin 2012, 98.3% e njerëzve në vendet anëtare të BE-së kanë pasur qasje në kujdesin shëndetësor.⁷⁹ Në përgjithësi ndërmjet vitit 2005 dhe 2012, përqindja e njerëzve me qasje në kujdesin shëndetësor në vendet e EQL ishte mesatarisht 7.1 pikë përqindje më e ulët se në vendet e tjera të BE-së.⁸⁰ Ndërkohë, qasja në kujdesin shëndetësor në vendet e

Figura 9. Qasja në Kujdesin Shëndetësor



EJL ishte mesatarisht 3.0 pikë përqindjeje më e ulët se në vendet që nuk i takojnë EJL. Megjithatë, kjo nuk ishte statistikisht e rëndësishme. Gjatë periudhës prej vitit 2005 deri në vitin 2010, mesatarisht, qasja në shëndetësi është rritur në mënyrë të konsiderueshme në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, por nuk kishte asnjë ndryshim në vendet që nuk i takojnë EQL. Në të gjitha vendet, nuk ka pasur asnjë ndryshim gjatë kësaj periudhe sa i përket qasjes në kujdesin shëndetësor përkitazi me dallimet gjinore. Në vendet e EQL, përqindja e grave me qasje në kujdesin shëndetësor ka qenë vazhdimisht më e ulët se e burrave; mesatarisht 1.7% më shumë meshkuj kanë pasur qasje në kujdesin

⁷⁶ Grupi i Bankës Botërore në Kosovë, 'Fotografia e Vendi', prill 2015 f. 6, në:

<http://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/document/eca/Kosovo-Snapshot.pdf>.

⁷⁷ Bashkimi Evropian, 'BE sipas Temës: Shëndeti, në: https://europa.eu/european-union/topics/health_en.

⁷⁸ Anëtarët e RrGGK-së identifikuan shëndetin si çështje kyçe për gratë në Strategjinë RrGGK-së për 2015-2018, dhe Lobi i Kosovës për anëtarë për Barazi Gjinore kanë theksuar rëndësinë e saj, gjatë takimeve në vitin 2016.

⁷⁹ IEBGJ, 'Indeksi për Barazi Gjinore: Qasja në Shëndetësi 2012', qasur më 4 dhjetor 2016, në:

<http://eige.europa.eu/gender-statistics/gender-equality-index/2012/domain/health/2>.

⁸⁰ Bazuar në analizat e vendeve si në vijim: Austria, Belgjika, Bullgaria, Kroacia, Qipro, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Irlanda, Italia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Malta, Holanda, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia dhe Mbretëria e Bashkuar.


shëndetësor sesa femrat. Në vendet që nuk i takojnë EQL, nuk kishte dallim të madh në mes të meshkujve dhe femrave.

Një masë tjetër e gjendjes shëndetësore është se si njerëzit e perceptojnë cilësinë e tyre aktuale të shëndetit, duke filluar nga shumë e keqe deri në shumë të mirë. Shëndeti i vetë-perceptuar përkufizohet nga përqindja e njerëzve të cilët e konsiderojnë shëndetin e tyre 'të mirë' ose 'shumë të mirë'. Mesatarisht, shëndeti i vetë-perceptuar i femrave ishte 6.1 pikë përqindje më i ulët se shëndeti i meshkujve. Shëndeti i vetë-perceptuar ishte mesatarisht për 14.7% më i ulët në vendet e EQL-se sesa në vendet që nuk i takojnë EQL. Nga viti 2005 deri në vitin 2010, ka pasur një ndryshim të madh në shëndetin e vetë-perceptuar në vendet e EQL, por nuk ka pasur ndryshim të madh me kalimin e kohës në vendet që nuk i takojnë EQL. Mesatarisht, shëndeti i vetë-perceptuar ishte rritur 5.7% në vendet e EQL. Ngritja e shëndetit të perceptuar ishte e ngjashme për meshkujt dhe femrat. Prapëseprapë është vështirë të konkludohet nëse ky ndryshim kishte ndodhur si rezultat i anëtarësimit në BE, pasi që kishte të dhëna vetëm për periudhën pasi vendet tanimë ishin anëtarësuar në BE.

Në vitin 2016, 81% e kosovarëve e perceptuan shëndetin e tyre si 'shumë të mirë' ose 'të mirë', që tejkalon mesataren e gjendjes shëndetësore të vetë-perceptuar të vendeve të BE-së: 67%.⁸¹ E femrave kosovare në përgjithësi e perceptuan gjendjen e tyre shëndetësore të jetë më e keqe sesa meshkujt,⁸² që është e ngjashme me hendekun mesatar gjinor të BE-së të 5 pikë përqindjeje.

Pavarësisht vlerësimit përgjithësisht pozitiv të shëndetit të tyre nga ana e kosovarëve, sfidat duket se ekzistojnë në qasjen e kujdesit shëndetësor. Në 12 muaj para qershorit 2016, 25.9% e kosovarëve kanë thënë se kanë pasur të paktën një herë një mundësi kur ata kishin nevojë që të konsultohen me një mjek, por nuk e bënë këtë. Kjo është dukshëm më e lartë se sa në shtetet anëtare të BE-së, ku nevoja e paplotësuar është 6.7% mesatarisht.⁸³ Në Kosovë, nuk kishte dallim në mes të nevojave të paplotësuar të kujdesit shëndetësor të femrave dhe të meshkujve në bazë të këtij treguesi. Megjithatë, masat e tjera të qasjes në kujdesin shëndetësor tregojnë se gratë mund të përballen me më shumë pengesa në qasjen ndaj kujdesit shëndetësor në Kosovë sesa burrat. Për shembull, aktivistët kanë vënë në dukje se gratë dhe burrat me aftësi të kufizuara ndeshen me vështirësi shtesë.⁸⁴ Sa i përket kujdesit dentar, 18% e kosovarëve, në krahasim me 7.6% të personave në BE,⁸⁵ thanë se kishin nevojë për kontroll dentar apo trajtim gjatë 12 muajve të fundit, por nuk e shfrytëzuan këtë.

Figura 10. Shëndeti i Perceptuar Sipas Gjinisë dhe Vendeve



⁸¹ 'Statistikat e shëndetit të vetë-perceptuar', Eurostat, qasur më 28 nëntor 2016, në:

http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Self-perceived_health_statistics. Krahasimet që vijnë gjithashtu dalin nga ky burim. Të gjitha informatat që kanë të bëjnë me Kosovën në këtë seksion rrjedhin nga një sondazh kombëtar të amvisërive nga RrGGK në vitin 2016, përveç nëse tregohet ndryshe (Nicole Farnsworth, Dr. Katja Goebbels dhe Rina Ajeti për RrGGK, *Qasje në kujdesin shëndetësor në Kosovë*, Prishtinë: RrGGK, e ardhshme 2016).

⁸² RrGGK të dhëna nga anketa, 2016 ($p=0.01$).

⁸³ 'Statistikat e nevojave të paplotësuar shëndetësore', Eurostat, qasur më 29 nëntor 2016, në:

http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Unmet_health_care_needs_statistics.

⁸⁴ Këto janë identifikuar si problematike nga Lobi i Kosovës për Barazi Gjinore, takim, Durrës, 2016

⁸⁵ 'Statistikat e nevojave të paplotësuar shëndetësore', Eurostat.

Pasi kujdesi shëndetësor është kryesisht përgjegjësi e shteteve individuale, BE-ja ka pak ndikim në çështjet që lidhen me shëndetin, të cilat mund të pengojnë ndonjë ndikim që anëtarësimi në BE mund të ketë në qasjen në kujdesin shëndetësor në Kosovë. Megjithatë, parimet e përgjithshme të mosdiskriminimit të BE-së mund të sigurojnë një mbrojtje ligjore për të pasur qasje në kujdesin shëndetësor pa diskriminim në bazë të gjinisë.⁸⁶

Kujdesi ndaj fëmijëve

KE ka theksuar se "Për të përmirësuar dhe për të rritur integritetin e grave në tregun e punës, duhet të përmirësohet ekuilibri në mes të punës dhe jetës private " në shtetet anëtare.⁸⁷ Gjithashtu, disponueshmëria e cilësisë së lartë, objektet e përballeshme për kujdesin ndaj fëmijëve për fëmijët e vegjël është identifikuar si prioritet për Bashkimin Evropian.⁸⁸ Në vitin 2002, Këshilli Evropian përcaktoi Objektivat e Barcelonës, sipas të cilëve, "Shtetet anëtare duhet hequr pengesat ndaj pjesëmarrjes së femrave në fuqinë punëtore, duke marrë parasysh kërkesën për objektet e kujdesit për fëmijët dhe në përputhje me modelet kombëtare të ofrimit, për të siguruar kujdesin ndaj fëmijëve deri në vitin 2010 për të paktën 90% të fëmijëve në mes të moshës 3 vjeç dhe moshës së shkollës dhe të paktën 33% e fëmijëve nën 3 vjeç".⁸⁹

Në përgjithësi, vetëm gjashtë shtete anëtare të BE-së kanë arritur të zbatojnë plotësisht Objektivat e Barcelonës.⁹⁰ Deri në vitin 2014, 10 nga 28 shtete kanë arritur synimin që të sigurojnë që të paktën 90% të fëmijëve të moshës tre vjet deri në moshën e detyrueshme shkollë të kenë pasur qasje në kujdesin ndaj fëmijëve: Belgjika, Danimarka, Finlanda, Franca, Luksemburgu, Holanda, Portugalia, Sllovenia, Spanja dhe Suedia. Vetëm nëntë vende i plotësuan objektivin për të siguruar kujdesin ndaj fëmijëve për të paktën 33% të fëmijëve nën moshën tre vjeçare: Belgjika, Danimarka, Estonia, Franca, Italia, Malta, Sllovenia, Spanja dhe Suedia. Sllovenia është identifikuar si një shembull pozitiv, ku rritja e disponueshmërisë për kujdesin ndaj fëmijëve i atribuohet pjesërisht një amendamenti në ligjin për kopshte në vitin 2008 'i cili futi kujdesin ndaj fëmijëve të financuar nga shteti për fëmijët e dytë dhe pasues'.⁹¹

Vetëm dy vende kanë të dhëna në dispozicion për periudhën para dhe pas anëtarësimit në BE: Bullgaria dhe Kroacia. Për këto vende, nuk ka ndryshim statistikisht të madh në përqindjen e fëmijëve të moshës tre dhe nën këtë moshë të cilët kishin qasje në kujdesin ndaj fëmijëve në afat të shkurtër para dhe pas anëtarësimit në BE.

Në Kosovë, vetëm 3.7% e fëmijëve të moshës 0-5 dhe 74% e fëmijëve të moshës 5-6 ndjekin arsimin parashkollor.⁹² Rreth 15.5% e fëmijëve kosovarë shfrytëzojnë kujdesin ndaj fëmijëve. Shumica e shërbimeve për kujdesin ndaj fëmijëve janë të vendosura në Prishtinë, dhe zonat rurale në veçanti kanë tendencë për mungesë të qasjes në kujdesin ndaj fëmijëve.⁹³ KE ka vërejtur në Raportin e Vendit 2016

⁸⁶ Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, 2009, neni 10 dhe neni 19, dhe Traktati për Bashkimin Evropian, 2009, neni 3, para. 2.

⁸⁷ Komisioni Evropian, *Punësimi në Evropë 2010*, Luksemburg: Zyra e Botimeve të Bashkimit Evropian, 2010, f. 102.

⁸⁸ Komisioni Evropian, "Raport nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Evropian Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve: Objektivat e Barcelonës: Zhvillimi i objekteve për kujdesin ndaj fëmijëve për fëmijët e vegjël në Evropë me qëllim të rritjes së qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse", SWD (2013) 192 final 2013.

⁸⁹ Po aty.

⁹⁰ Llogaritjet e RrGGK-së bazuar në të dhënat statistikore të vendeve nga Eurostati

⁹¹ Komisioni Evropian, 'Raport nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Evropian Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve: Objektivat e Barcelonës: Zhvillimi i objekteve për kujdesin ndaj fëmijëve për fëmijët e vegjël në Evropë me qëllim të rritjes së qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse', f. 6.

⁹² Komisioni Evropian, *Kosovë* 2016 Raport*, Bruksel: Komisioni Evropian, 2016, f. 53.

⁹³ Nicole Farnsworth et al. për RrGGK, *Kush kujdeset? Kërkesat, ofertat dhe opsionet për rritjen e mundësive të kujdesit të fëmijëve në Kosovë*, Prishtinë: RrGGK, 2016, në:

<http://www.womensnetwork.org/documents/20161103153827186.pdf>.

për Kosovën se qasja e kufizuar në kujdesin ndaj fëmijëve dhe organizimet fleksibile të punës janë pengesa për punësimin e grave, pasi që mundësitë formale për kujdesin përtej pushimit të lindjes janë të kufizuara, dhe oraret familjare-miqësore shpesh nuk janë në dispozicion.⁹⁴ Zgjerimi i kujdesit ndaj fëmijëve në Kosovë është prioritet në kuadër të Strategjisë së Zhvillimit Kombëtar të Qeverisë për 2016-2021.⁹⁵ Financimi IPA ndoshta mund të mbështesë zgjerimin e disponueshmërisë së kujdesit ndaj fëmijëve në Kosovë në të ardhmen, që gjithashtu mund të kontribuojë në rritjen e performancës arsimore për fëmijë.⁹⁶

Vlerësime tjera të proceseve të anëtarësimit në BE dhe ndikimi i tyre në Barazinë Gjinore

Pjesa e parë kryesisht u nxor nga analiza e të dhënave kuantitative. Megjithatë, barazia gjinore mund të jetë një koncept i vështirë për t'u realizuar, dhe vetëm masat e marra kuantitative nuk mund të përfshijnë plotësisht ndikimin që anëtarësimi në BE mund të ketë për femra dhe meshkuj. Ndoshta fushat e përzgjedhura të studimit dhe të metodologjisë të përdorura mund të kenë humbur masa të tjera të rëndësishme të barazisë gjinore. Në këtë pjesë shqyrtohen shkurtimisht disa nga literaturat ekzistuese, duke paraqitur trendet që autorë e tjerë kanë identifikuar në lidhje me pranimin në BE dhe barazinë gjinore.

Sipas Maria Stratigaki, në vitet e para, politika e BE-së kishte përdorur gjuhën e 'ndarjes', duke i ftuar burrat dhe gratë që të ndajnë punët e shtëpisë për të zvogëluar barrën e vendosur mbi gratë, duke e bërë fuqinë punëtore më të arritshme për to.⁹⁷ Me kalimin e kohës, politika e BE-së kaloi në një gjuhë të 'pajtimit', argumenton Stratigaki. Kjo fokusohet më shumë në krijimin e orareve fleksibile që u mundësojnë grave që të kryejnë edhe punët në shtëpi edhe ato në vendin e punës, në vend të zhvendosjes së marrëdhënieve gjinore në mënyrë që gratë dhe burrat mund të jenë më të barabartë. Për shembull, në shumë pjesë të Evropës Juglindore (siç janë Greqia, Italia dhe Spanja) gjuha e pajtimit e BE-së është përdorur më shpesh për të inkurajuar role-stereotipe gjinore në familje dhe në tregun e punës. Në këtë rast, politikat e BE-së mund të kenë një ndikim negativ në barazinë gjinore duke përforcuar rolet tradicionale gjinore në vend të rishpërndarjes së formave të ndryshme të punës së paguar dhe punës së papaguar në mënyrë më të barabartë mes të grave dhe burrave.

Në mënyrë të ngjashme, MacRae ka argumentuar se pavarësisht urgjencës së një 'projekti gjinor' në të gjithë BE-në, politika e BE-së është të paktën pjesërisht përgjegjëse për krijimin dhe forcimin e dallimeve gjinore.⁹⁸ Sipas saj, strategjitë e BE-së për avancimin e barazisë gjinore nëpërmjet integritit dhe vlerësimeve të ndikimit gjinor janë të pamjaftueshme për tejkalimin e qasjes më të gjerë ekonomike neo-liberale të BE-që i jep prioritet liberalizimit të tregtisë se sa barazisë gjinore. Sipas mendimit të saj, vlerat thelbësore të politikës ekonomike të BE-së mund të kenë ndikim negativ në barazinë gjinore.

Pranimi në BE mund të ketë ndikuar në vende në mënyra të ndryshme, siç janë ilustruar disa nga diskutimet e mëparshme në këtë punim. Analiza sasiore në një nivel multi-vendor mund të errësojë nuancat që mund të ekzistojnë në vende të veçanta, duke përfshirë faktorë të veçantë politikë, sociale dhe ekonomike të vendeve. Përvojat e studimeve të vendeve lidhur me pranimin në BE ishte jashtë

⁹⁴ Komisioni Evropian, *Kosovë * 2016 Raport*.

⁹⁵ Republika e Kosovës, Zyra e Kryeministrit, *Strategjia Kombëtare për Zhvillim për 2016-2021*, Prishtinë: 2016.

⁹⁶ For Për më shumë informata, shih Farnsworth et al. për RrGGK, *Kush kujdeset?*

⁹⁷ Maria Stratigaki: 'Kooptimi i koncepteve gjinore në politikat e BE-së: Rasti i 'Pajtimit i Punës dhe Familjes', *Politika Sociale: Studime Ndërkombëtare Gjinore, shtet dhe shoqëri*, 11.1, 2004, fq 30-56..

⁹⁸ MacRae, Heather. '(Ri-) Integrimi gjinor: Rezultatet e Paqëllimshme dhe të Papritura Gjinore të Politikave të Bashkimit Evropian', *Studimi i Forumit Ndërkombëtar të Gruas*, 39, korrik-gusht 2013 f 3-11.

objektit të këtij hulumtimi të veçantë, i cili u përqendrua në trendet më të gjerë. Megjithatë, një rishikim i literaturës ekzistuese sugjeron se vendet individuale mund të kenë pasur përvoja të ndryshme.

Për shembull, gjatë procesit të Anëtarësimit të Polonisë në BE, ishte vonuar miratimi i legjislacionit të mundësive të barabarta. Sipas Regulska dhe Grabowka, kjo vonesë ka rezultuar nga kundërshtimi i organizuar ndaj ligjeve të BE-së për barazinë gjinore dhe partitë me prirje të djathta në qeveri.⁹⁹ Bazuar në këtë përvojë, ata argumentuan se në fund të fundit institucionet shtetërore mund ta mundin politikën e BE-së, duke marrë vendimin përfundimtar për masën në të cilën shteti do të njohë dhe të mbrojë të drejtat e grave. Veçanërisht, gjatë negociatave të pranimit në BE, në mënyrë që të fitojë mbështetjen e Kishës Katolike për të hyrë në BE, Polonia është konsideruar se ka kufizuar qasjen e grave në abort.¹⁰⁰ Edhe pse zgjati më shumë në Poloni sesa në vendet e tjera, BE-ja në fund ka arritur të inkurajojë miratimin e legjislacionit të mundësive të barabarta.

Krahasuar me Poloninë, ligjet u miratuan më lehtë në Republikën Çeke. Anderson konsideroi këtë si rezultat të burimeve financiare dhe politike të BE-së, të cilat BE-ja i shfrytëzoi për të krijuar nxitje, duke ndikuar në aktorët politikë që të miratojnë politika të veçanta.¹⁰¹ Haskova dhe Krizkova në mënyrë të ngjashme e shohin procesin e pranimit të Republikës Çeke si 'forca më e rëndësishme e legjitimitetit që ndihmoi për të promovuar barazinë gjinore'.¹⁰² Përderisa një kornizë e përgjithshme për barazi gjinore ekzistonte në kuadër të kushtetutës çeke para fillimit të procesit të pranimit në BE, kërkesat e BE-së gjatë këtij procesi kontribuuan në forcimin e këtyre politikave, veçanërisht në lidhje me Kodin e Punës.¹⁰³ Në të vërtetë, aktivistë për të drejta të grave në vendet e tjera e kanë vërejtur rëndësinë e shfrytëzimit të procesit të pranimit në BE për të krijuar masa mbrojtëse ligjore që do të promovojnë barazinë gjinore dhe të mbrojnë të drejtat e grave në të ardhmen.¹⁰⁴ Pasi vendet i janë bashkuar BE-së, aktivistët për të drejta të grave kanë konstatuar që është bërë veçanërisht e vështirë për të vënë prioritetet e barazisë gjinore në rend të ditës apo të mbajnë vendet përgjegjëse për zbatimin e politikave të cilat ekzistojnë.

Në Bullgari, Fondacioni për Kërkime Gjinore i Bullgarisë ka vënë re se në komunizëm, qeveritë e mëparshme kishin bërë hapa të konsiderueshëm drejt krijimit të kujdesit shëndetësor universal dhe arsimit, si dhe rritjes së qasjes së grave në punësim të paguar.¹⁰⁵ Gratë e punësuarat kanë pasur qasje në kujdesin publik ndaj fëmijëve, pushimit të paguar të lehonisë, shtesa familjare dhe shërbime pas shkollës për fëmijët. Tranzicioni drejt demokracisë dhe kapitalizmit, i cili i paraprin procesit të hyrjes në BE, ka kontribuar në një rënie në disponueshmërinë e kujdesit të përballeshëm ndaj fëmijëve, që duket se ka ndikuar negativisht në normat e punësimit të grave. Në këtë kontekst, organizatat për të drejtat e grave e konsideruan procesin e pranimit në BE si një mundësi për instalimin e politikave që mund të ndihmojnë në adresimin e këtyre çështjeve. Megjithatë, krijimi i politikave të tjera në drejtim të barazisë gjinore gjatë procesit të pranimit në BE hasi në rezistencë për shkak të supozimeve se barazia gjinore tashmë ishte arritur. Bullgaria gjithashtu u përball me sfidën e sigurimit se barazia gjinore siç përcaktohet në politikë ishte zbatuar në praktikë.

⁹⁹ Regulska, Joanna dhe Magda Grabowka: 'A do të bëjë një ndryshim?: Zgjerimi i BE-së dhe Diskursi Publik i Grave në Poloni', në *Politikën Gjinore në Zgjerimin e Bashkimit Evropian*, Silke Rothe (ed.), Shtetet e Bashkuara: Berghahn Books, 2008. Qasja online nëpërmjet Google Books

¹⁰⁰ Angelika von Wahl, 2008.

¹⁰¹ Leah Seppanen Anderson, 'European Union Gender Regulations in the East: The Czech and Polish Accession Process', *Eastern European Politics and Societies*, 20: 101 (2006), pp. 101-125.

¹⁰² Haskova, Hana dhe Alena Krizkova, 'Ndikimi i Anëtarësimit në BE për Promovimin e Grave dhe Barazinë Gjinore në Republikën Çeke', në *Politikën Gjinore për zgjerimin e Bashkimit Evropian*, Silke Rothe, ed. Shtetet e Bashkuara: Berghahn Books 2008

¹⁰³ Michaela Marksova-Tominova, 2003.

¹⁰⁴ Diskutimet e RrGGK-së me aktivistë për të drejta të grave nga vendet e tjera, duke përfshirë Kroacinë, Rumaninë dhe Poloninë.

¹⁰⁵ Fondacioni për Kërkime Gjinore i Bullgarisë, 2003.

Përfundim

Ky hulumtim ka për qëllim që të shqyrtojë nëse anëtarësimi në BE ndikon në barazinë gjinore me qëllim të nxjerrjes së mësimave nga përvojat e vendeve të tjera dhe të bëjë rekomandime të politikave që mund të informojnë procesin e anëtarësimit të Kosovës në BE. Gjetjet sugjerojnë se duke krahasuar periudhën gjatë procesit të anëtarësimit me periudhën pas anëtarësimit në BE, deri më sot, nuk ka rezultuar me ndryshime të mëdha që kanë të bëjnë me barazinë gjinore, pozitive apo negative. Ka pasur përmirësime në barazinë gjinore në disa vende në fusha të caktuara, siç janë pjesëmarrja politike, normat e papunësisë, hendeku gjinor i pagave, qasja në shëndetësi dhe arsim të lartë. Megjithatë, për shkak të të dhënave të pamjaftueshme, nuk është e mundur që të vërtetohet se anëtarësimi në BE mund t'i ketë kontribuar këtyre përmirësimeve. Hendeku midis normave të punësimit të grave dhe burrave, normat ekzistuese të varfërisë ose përfundimi i shkollës së mesme të lartë nuk kanë ndryshuar shumë që kur vendet filluan procesin e pranimit. Ndoshta për disa vende, anëtarësimi në BE mund të ketë kontribuar pak pozitivisht në zvogëlimin e hendekut gjinor të pagave; megjithatë, në vende të tjera ai nuk ka pasur efekt pozitiv. Normat e punësimit janë rritur edhe për meshkuj edhe për femra, edhe pse diferenca midis grave dhe burrave duket se ka mbetur e njëjtë. Është e qartë, faktorët më të gjerë politikë dhe ekonomikë mund të ndikojnë në masën në të cilën BE-ja ka fuqi për të ndikuar në barazinë gjinore. Për shembull, efektet e recesionit ekonomik të vitit 2008 do të mund të kenë peshuar më shumë se çdo ndikim pozitiv ose negativ që politikat e BE-së mund të kenë pasur. Shkalla në të cilën krizat ekonomike mund të kenë ndikuar te gratë, burrat dhe barazia gjinore mund të përfitojë nga një studim i mëtejshëm.

Çështje që vlen të përmendet është se analiza statistikore e ndërmarrë këtu nuk ka shqyrtuar hollësisht vende të caktuara, ku pranimi në BE mund të ketë ndikuar në barazinë gjinore. Anëtarësimi në BE mund të ndikojë në barazinë gjinore ndryshe në vende të veçanta, duke pasur parasysh specifikat e tyre kulturore, sociale, politike dhe ekonomike. Polonia, për shembull, fillimisht përjetoi rezistencën ndaj *acquis* të BE-së për barazi gjinore nga disa aktorë politikë dhe fetarë. Në Republikën Çeke, procesi i pranimit në BE nxiti përmirësimin e politikave drejt barazisë gjinore. Vende të tjera mund të kenë shembuj të tjerë nga të cilat Kosova mund të mësojë, pas studimit të mëtejshëm.

Në lidhje me fushat për hulumtimet e ardhshme, një mësim i rëndësishëm i provuar në kryerjen e analizave statistikore është rëndësia e mbledhjes së të dhënave të standardizuara të ndara sipas gjinive nëpër vende dhe me kalimin e kohës. Mungesa e të dhënave të krahasueshme dhe të standardizuara në dekadat para pranimit në BE kishte dëmtuar përpjekjet për të identifikuar trendet me kalimin e kohës. Edhe pse një përfitim nga përdorimi i të dhënave nga Eurostat është se të dhënat e standardizuara mundësojnë krahasime me kalimin e kohës dhe në mesin e vendeve, atyre shpesh u mungonin të dhënat për periudhën përpara se vendet kishin filluar proceset e tyre të pranimit në BE. Nëse ishin në dispozicion më shumë të dhëna historike, ndoshta duke shkuar më larg prapa në kohë mund të zbulohen disa ndryshime të ndikuara nga pranimi në BE. Veçanërisht, ndryshimet sociale marrin kohë. Ndoshta ndikimi i anëtarësimit në BE që mund të ketë në një vend të caktuar mund të mos jetë i dukshëm brenda afatit kohor relativisht të shkurtër të studimit. Përsëritja e studimeve të ngjashme pas disa viteve nga tani mund të zbulojë se ndryshimet ndodhin me kalimin e kohës, duke ndaluar çdo ndikim më të gjerë politik dhe ekonomik.

Në përgjithësi, duke pasur parasysh këto sfida metodologjike, konstatimi se pabarazitë gjinore vazhdojnë edhe pasi bëhet anëtarësimi në BE është një gjetje interesante, sepse ajo tregon se përafrimi i politikave me kriteret e Kopenhagës dhe me *acquis* për barazi gjinore nuk është i mjaftueshëm për avancimin e barazisë gjinore, të paktën në periudhën afatshkurtër.

Ndoshta vetë politikat e BE-së mund të mos jenë mjaft të ndjeshme ndaj barazisë gjinore për të kontribuar në avancimin e saj. Siç u diskutua, disa autorë kanë shprehur shqetësimin se trupi më i gjerë i politikave të BE-së mund të dëmtojë barazinë gjinore, siç është përmes politikave neo-liberale ekonomike; ose inkurajimit të grave për 'pajtimin' e punës së papaguar në familje me punë të paguar jashtë shtëpisë, që nuk kontribuon në transformimin e roleve dhe marrëdhënieve gjinore të pabarabarta.

Është e qartë se Kosova i ndjek prapa shtetet anëtare të BE-së, mesatarisht, në lidhje me shumicën e indikatorëve të barazisë gjinore të shqyrtuar këtu. Me gjetjet nga kjo analizë statistikore, është e vështirë të parashikohet se si anëtarësimi në BE mund të ndikojë në barazinë gjinore në Kosovë. Duket se pranimi në BE në vetvete jo domosdoshmërisht do të adresojë pabarazitë gjinore në Kosovë. Qeveria e Kosovës, së bashku me qytetarët, duhet të marrë pronësinë, duke punuar në mënyrë të qëndrueshme për të adresuar pabarazitë gjinore, si pjesë e procesit të pranimit në BE, por edhe pasi pranimi në BE të përfundojë, në pajtim me kornizën ligjore të vetë Kosovës.

Ndoshta Kosova mund të mësojë nga përvojat individuale të vendeve në anëtarësimin në BE/ Për shembull, përvoja e Republikës Çeke sugjeron se procesi i pranimit në BE mund të jetë i dobishëm për të krijuar politika të përmirësuara në drejtim të barazisë gjinore. BE-ja mund ta stimulojë Qeverinë e Kosovës që të miratojë politika që do të kontribuojnë në avancimin e barazisë gjinore. BE-ja mund të vendosë shembull pozitiv duke i dhënë prioritet barazisë gjinore në të gjitha programet dhe duke shtyrë në vazhdimësi Qeverinë e Kosovës që të sigurojë sundimin e ligjit, duke përfshirë zbatimin e kornizës ligjore ekzistuese që ka të bëjë me barazinë gjinore. Në të vërtetë, Plani i ri i veprimit gjinor i BE-së bën thirrje për një qasje të tillë në emër të të gjitha delegacioneve të BE-së.¹⁰⁶ Ndërkohë, siç tregohet në Poloni dhe në Republikën Çeke, grupet e grave të shoqërisë civile mund të shfrytëzojnë momentin e procesit të pranimit në BE për të avokuar për barazi gjinore edhe në politikë edhe në praktikë. Duke ndjekur me kujdes se si procesi i pranimit të Kosovës në BE kontribuon për barazinë gjinore me kalimin e kohës, duke filluar nga tani, mund të sigurojë informata të dobishme për studiuesit dhe politikëbërësit në të ardhmen.

¹⁰⁶ Këshilli i Bashkimit Evropian, Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit, 'Konkluzionet e Këshillit për Planin e Veprimit Gjinor 2016-2020', Bruksel: Këshilli i Bashkimit Evropian, 2015.

Bibliografia

- Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për Barazi Gjinore Nr. 05 / L-020, 28 maj 2015, në: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/05-L-020%20a.pdf>.
- Fondacioni Bullgar për Hulumtime Gjinore, *Vlerësimi gjinor i ndikimit të anëtarësimit në BE në Statusin e Grave dhe tregun e punës në EQL, Studim Kombëtar*: Bullgari, Karat Koalicioni dhe UNIFEM, Sofje: 2003
- Burri, Susanne dhe Sacha Prechal, *Ligji i BE-së për Barazi Gjinore, Azhurnuar në vitin 2013*.
_____. *Transpozimi i Direktivës Përmbledhëse 2006/54/EC, 2009*, në: http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/files/2009reportrecastdirectivefinal_en.pdf
- Kryetari i Samitit të Parisit për Ballkanin Perëndimor, Deklarata nga Samiti i BE-së për Ballkanin Perëndimor, Selanik, 21 qershor 2003, në: <http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/policy-highlights/regional-cooperation/20160713-01.final-declaration-by-the-chair-of-the-paris-western-balkans-summit.pdf>
- Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (2000/C 364/01), në: http://www.europarl.europa.eu/charter/pdf/text_en.pdf
- Këshilli i Bashkimit Evropian, Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit, 'Përfundimet e Këshillit për Planin e Veprimt Gjitor 2016-2020', Bruksel: Këshilli i Bashkimit Evropian, 2015.
- El-Cherkeh, Tanja, Elena Stirbu, Sebastian Lazaroiu dhe Dragos Radu, *Zgjerimi i BE-së, Migrimi dhe Trafikimi i grave: Rasti i Evropës Juglindore*, Instituti i Hamburgut i Ekonomisë Ndërkombëtare, 2004.
- Eur Lex (qasje në të drejtën e Bashkimit Evropian), 'Kriteret e pranimit (Kriteret e Kopenhagës)', në: http://eur-lex.europa.eu/summary/glossary/accession_criteria_copenhagen.html.
- _____. Versioni i konsoliduar i Traktatit për Bashkimin Evropian
- _____. Versioni i konsoliduar i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian
- _____. 'Përmbledhje e Direktivës së Këshillit 92/85/EEC',
në: <http://eurlex.europa.eu/legalcontent/EN/TXT/HTML/?uri=URISERV:c10914&from=EN>.
- _____. 'Përmbledhje e Direktivës së Këshillit 2004/113/EC', Eur Lex, në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=URISERV%3Ac10935>.
- _____. 'Përmbledhje e Direktivës 2011/36/EU', Eur Lex, në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=URISERV%3Ajl0058>
- Këshilli Evropian, Direktiva e Këshillit 75/117/EEC e 10 shkurtit 1975 për përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me zbatimin e parimit të pagesës së barabartë për burrat dhe gratë, at: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A31975L0117>.
- _____. Direktiva e Këshillit 76/207/EEC e 9 shkurtit 1976 për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë për sa i përket qasjes në punësim, trajnim profesional dhe promovim, si dhe kushtet e punës në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A31976L0207>
- _____. Direktiva e Këshillit 86/378/EEC e 24 korrikut 1986 për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë në skemat e sigurimit social në punë, në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A31986L0378>.
- _____. Direktiva e Këshillit 2000/43/EC e 29 qershorit 2000 për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike.
- _____. Direktiva e Këshillit 2010/18/EU e 8 marsit 2010 zbatimin e Marrëveshjes së rishikuar Kornizë për pushim prindëror të realizuar nga BUSINESSEUROPE, UEAPME, CEEP dhe ETUC dhe shfuqizimin e Direktivës 96/34/EC në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex:32010L0018>
- _____. Direktiva e Këshillit 97/80/EC e 15 dhjetorit 1997 mbi barrën e provës në rastet e diskriminimit në bazë të gjinisë, në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A31997L0080>
- _____. Direktiva 2010/41/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 7 korrikut 2010 për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave të angazhuar në një aktivitet në cilësi të vetë-punësuarit e cila shfuqizon Direktivën e Këshillit 86/613/EEC në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex:32010L0041>
- _____. Direktiva 2011/24/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 9 marsit 2011 për zbatimin e të drejtave të pacientëve në kujdesin shëndetësor ndërkufitar, në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32011L0024>
- _____. 'Politika Evropiane e Fqinjësisë dhe Negociatat për Zgjerim: Kosovë', në: http://ec.europa.eu/enlargement/countries/detailed-country-information/kosovo/index_en.htm
- Komisioni Evropian, *Punësimi në Evropë* 2010, Luksemburg: Zyra e Botimeve e Bashkimit Evropian, 2010.
- _____. 'Deklaratë e përbashkët e Përfaqësuesit të Lartë /Zëvendës-Presidenti Federica Mogherini dhe Komisioneri Johannes Hahn, me rastin e dorëzimit për aplikimin për anëtarësim të Bosnje-Hercegovinës' 2016 në: http://europa.eu/rapid/press-release_STATEMENT-16-303_en.htm.

- _____. *Kosovë* 2015 Raport*, Bruksel: EC, 2015, at:
http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_kosovo.pdf
- _____. *Kosovo* 2016 Raport*, Bruksel: Komisioni Evropian, 2016.
- _____. ' , Raporti nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Evropian Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve: Objektivat e Barcelonës: Zhvillimi i objekteve të kujdesit ndaj fëmijëve për fëmijët e vegjël në Evropë me qëllim të rritjes së qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse "SWD(2013) 192 final, 2013, në:
<http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/ALL/?uri=CELEX:52013DC0322>.
- _____. *Trajtimi i hendekut gjinor në Bashkimin Evropian*, Luksemburg: 2013, në:
http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/files/gender_pay_gap/130422_gpg_brochure_en.pdf
- _____. *Trajtimi i hendekut gjinor në Bashkimin Evropian*, Luksemburg, 2014, në:
http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/files/gender_pay_gap/140319_gpg_en.pdf
- Gjykata Evropiane e Drejtësisë, 8 prill 1976, Rasti 43/75 Gabrielle Defrenne v Société Anonyme Belge de Navigation Aérienne Sabena [1976] ECR 455 (Defrenne II).
- _____. 10 shkurt 2000, Rasti C-50/96 Deutsche Telekom AG, ish Deutsche Bundespost Telekom v Lilli Schröder [2000] ECR I-743 (Schröder).
- _____. 15 qershor 1978, Rasti 149/77, Gabrielle Defrenne v Société Anonyme Belge de Navigation Aérienne Sabena [1978] 1365 (Defrenne III).
- Instituti për Barazi Gjinore. Indeksi i BE-së për Barazi Gjinore. në: <http://eige.europa.eu/rdc/eige-publications/gender-equality-index-2015-measuring-gender-equality-european-union-2005-2012-report>.
- _____. 'Pekin +20: Platforma për Veprim (BPfA) dhe Bashkimit Evropian Zona A: Gratë dhe Varfëria ' në:
http://eige.europa.eu/sites/default/files/documents/A_MH0415022ENC.pdf.
- _____. 'Statistikat Gjinore Baza e të dhënave ', IEBGJ, qasur më 9 dhjetor 2016 në: <http://eige.europa.eu/gender-statistics/dgs/browse/ta>.
- Parlamenti Evropian, 'Të dhëna për Bashkimin Evropian: Ballkani Perëndimor', qasur më 3 dhjetor 2016 në:
http://www.europarl.europa.eu/atyourservice/en/displayFtu.html?ftuld=FTU_6.5.2.html.
- Eurostat, 'Statistikat e punësimit', qasur më 3 dhjetor 2016 në: http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Employment_statistics
- _____. 'Statistikat e vetë-perceptuara shëndetësore ', Eurostat, qasur më 28 nëntor 2016, në:
http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Self-perceived_health_statistics
- _____. 'Statistika e nevojave të paplotësuara të kujdesit shëndetësor ', Eurostat, qasur më 29 nëntor 2016, në:
http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Unmet_health_care_needs_statistics
- Eurostat Zyra e shtypit, 'Njoftim për shtyp : Pjesa e personave në rrezik nga varfëria apo përjashtimi social në BE kthehet në nivelin e tij para krizës', 2016, në:
<http://ec.europa.eu/eurostat/documents/2995521/7695750/3-17102016-BP-EN.pdf/30c2ca2d-f7eb-4849-b1e1-b329f48338dc>
- Zyra e Jashtme Commonwealth Londër, 'Tekste të konsoliduara të Traktateve të BE-së të ndryshuar me Traktatin e Lisbonës', Version i konsoliduar i Traktatit për Bashkimin Evropian, 2008, në:
https://www.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/228848/7310.pdf.
- Farnsworth, Nicole, Adelina Berisha, Erica Browne, Nerina Guri, Donike Kastrati dhe Gresa Rrahmani për RrGGK, *Kush kujdeset? Kërkesat, ofertat dhe opsionet për rritjen e mundësive të kujdesit të fëmijëve në Kosovë*, Prishtinë: RrGGK, 2016, në:
<http://www.womensnetwork.org/documents/20161103153827186.pdf>
- Farnsworth, Nicole, Dr. Katja Goebels dhe Rina Ajeti për RrGGK, *Qasja në Kujdesin Shëndetësor në Kosovë*, Prishtinë: RrGGK, i ardhshëm 2016.
- Färnsveden, Ulf, Ariana Qosaj-Mustafa, Nicole Farnsworth, *Kosovë Profili Gjinor i Vendit*, Prishtinë: Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar, 2014.
- Qeveria e Kosovës, 'Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit', Prishtinë: Qeveria e Kosovës, 2016, në: [http://www.mei-ks.net/repository/docs/3_pkzmsa_miraturar nga_kuvendi_final_eng .pdf](http://www.mei-ks.net/repository/docs/3_pkzmsa_miraturar nga_kuvendi_final_eng.pdf).
- Haskova, Hana dhe Alena Krizkova, 'Ndikimi i Anëtarësimit në BE për Promovimin e Grave dhe Barazinë Gjinore në Republikën Çeke', në *Politikën gjinore në zgjerimin e Bashkimit Evropian*, Silke Rothe, ed. Shtetet e Bashkuara: Berghahn Books, 2008.
- Hina, 'Kroacia renditet e 92-a sipas përqindjes së grave në parlament, Evropë Ballkan Lajmet e fundit, korrik 2016, në : <https://eblnews.com/news/croatia/croatia-ranked-92nd-percentage-women-parliament-30658>.
- Kantola, Johanna. Gjinia dhe Bashkimi Evropian, UK: Palgrave Macmillan 2010
- Karasavoglou, Anastasios, Serdar Ongan dhe Persefoni Polychronidou, *Kriza e BE-së dhe roli i periferisë*, Zvicër: Springer International Publishing, 2015

- Agjencia e Statistikave të Kosovës, 'Të dhënat e ASK-së: Regjistrimi i vitit 2011', në: http://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/en/askdata/askdata_Census%202011/?rxid=746bfe0d-92ce-4494-b62b-a26f21527d05.
- _____. *Statistikat e arsimit* 2012/2013, 2013/2014, dhe 2014/2015, në: <https://ask.rks-gov.net/arsimi/publikimet>.
- _____. *Statistikat e arsimit në Kosovë 2015/2016*, në: <http://ask.rks-gov.net/media/1658/statistikat-e-arsimit-n%C3%AB-kosov%C3%AB-2015-2016-m%C3%AB-30062016-versioni-i-fundit.pdf>.
- _____. *Migrimi në Kosovë*, Prishtinë: ASK, 2014, në: <http://kosovo.iom.int/sites/default/files/Migrimet%20English%20FINAL%2013082014.pdf>
- _____. *Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore të Kosovës 2015*, Prishtinë: 2016, në: <http://ask.rks-gov.net/media/1687/results-of-the-kosovo-2015-labour-force-survey.pdf>.
- Lobi për Barazi Gjinore në Kosovë, takim, Durres, 2016.
- RrGGK, *1325 Fakte dhe Fabula: Një koleksion i tregimeve rreth zbatimit të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për Gratë, Paqen dhe Sigurinë në Kosovë*, Nicole Farnsworth (ed.), Prishtinë: RrGGK, 2011, në: <http://www.womensnetwork.org/documents/20130120165559661.pdf>
- MacRae, Heather. '(Ri-) Integrimi gjinor: Rezultatet e Paqëllimshme dhe të Papritura Gjinore të Politikave të Bashkimit Evropian', Studimi i Forumit Ndërkombëtar të Gruas, 39, korrik-gusht 2013 f 3-11.
- Marksova-Tominova, Michaela, 'Vlerësimi gjinor i ndikimit të anëtarësimit në BE në Statusin e Grave dhe tregun e punës' në EQL, *Studim Kombëtar: Republika Çeke, Karat Koalicioni dhe UNIFEM*, Pragë: 2003.
- Morina, Donjeta dhe Nicole Farnsworth për RrGGK, *Buxhetimi drejt një arsimimi më të mirë*, Prishtinë: RrGGK, 2016, në: <http://www.womensnetwork.org/documents/20160607151528942.pdf>
- Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, 'Fjalor i termave statistikore: Vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore', azhurnuar më 2 nëntor 2001, në: <https://stats.oecd.org/glossary/detail.asp?ID=303>
- Regulska, Joanna dhe Magda Grabowka: 'A do të bëjë një ndryshim?: Zgjerimi i BE-së dhe Diskursi Publik i Grave në Poloni', në *Politikën Gjinore në Zgjerimin e Bashkimit Evropian*, Silke Rothe (ed.), Shtetet e Bashkuara: Berghahn Books, 2008. Qasja online nëpërmjet Google Books
- Republika e Kosovës, Zyra e Kryeministrit, 'Kryeministri Mustafa: Integrimi në BE, vlera drejtuese për shoqërinë kosovare', në: <http://kryeministri-ks.net/?page=2,9,5829>
- _____. Strategjia Kombëtare për Zhvillim për 2016-2021, Prishtinë: 2016 në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/National_Development_Strategy_2016-2021_ENG.pdf.
- Republika e Kosovës, 'Fjalimi i Presidentes Jahjaga në takimin e tretë të Këshillit Kombëtar për Integrim Evropian', në: http://www.president-ksgov.net/?page=2,8,2680#.WCWc4_krK00.
- Sajdik, Martin Michael Schwarzing, *Zgjerimi i Bashkimit Evropian: Historiku, Zhvillimet, Faktet*, 2008.
- Seppanen Anderson, Leah. 'Rregulloret Gjinore të Bashkimit Evropian në Lindje: Procesi i Pranimit çek dhe polak', *Politikat dhe Shoqëritë e Evropës Lindore*, 20: 101 (2006), pp 101-125
- Stratigaki, Maria. 'Kooptimi i Koncepteve gjinore në politikat e BE-së: Rasti i 'Paqimit të Punës dhe Familjes', *Politika Sociale: Studime Ndërkombëtare Gjinore, Shteti dhe Shoqëria*, 11.1, 2004, fq 30-56..
- UNDP, *Assistance Vlera e vërtetë e asistencës sociale*, Prishtinë: UNDP, 2014.
- Shtetet e Bashkuara të Amerikës Departamenti i Shtetit, *Raporti për Trafikimin e Personave*, Shtetet e Bashkuara: A /GIS/GPS 2015. *Zëri i Amerikës*: 'Intervista e Presidentit, Hashim Thaçi për Zërin e Amerikës', në: http://www.president-ksgov.net/?page=2,10,4372#.WCWWn_krK01.
- von Wahl, Angelika. 'BE-ja dhe Zgjerimi: Konceptualizimi përtej "Lindjes" dhe "Pernëdimit"', Silke Rothe (ed.), Shtetet e Bashkuara: Berghahn Books, 2008. Qasja online via Google Books.
- Witkowska, Dorota. 'Pabarazitë gjinore në tregun e punës të BE-së', *Përparimet në Kërkimet Ekonomike Ndërkombëtare*, 19:4 (nëntor 2013), pp. 331-334.